



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.77

2005

28 tetor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9423
datë 29.9.2005

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë për zhvillim ndërmjet
Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës
Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e menaxhimit
të integruar dhe pastrimit të zonës bregdetare”....

2539

Ligj nr.9424
datë 6.10.2005

Për ratifikimin e “Protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor”.

2553

Ligj nr.9425
datë 6.10.2005

Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e vitit
1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe”...

2565

L I G J
Nr.9423, datë 29.9.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË PËR ZHVILLIM NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS
NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E MENAXHIMIT TË
INTEGRUAR DHE PASTRIMIT TË ZONËS BREGDETARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë për zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e menaxhimit të integruar dhe pastrimit të zonës bregdetare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4672, datë 20.10.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE HUAJE PËR ZHVILLIM
(PROJEKTI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR DHE I PASTRIMIT TË ZONËS BREGDETARE)
MIDIS SHQIPËRISË DHE SHOQATËS PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

Marrëveshje e datës 21 prill 2005, midis Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (Shoqata).

A) Shoqata ka marrë një letër nga Huamarrësi të datës _____, në të cilën përshkruhet një program për kryerjen e reformave në politika, zhvillim institucional dhe investime për mbrojtjen e burimeve bregdetare dhe nxitjen e një zhvillimi dhe menaxhimi të qëndrueshëm të bregdetit të Huamarrësit (Programi), dhe nëpërmjet së cilës Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për zbatimin e këtij programi;

B) Huamarrësi kërkon që Shoqata të financojë zbatimin e programit të Huamarrësit nëpërmjet një sërë kredish, të cilat do të ekzekutohen përgjatë një periudhe prej afërsisht shtatë vjetësh dhe që do të përdoren nga Huamarrësi për zbatimin e projektit;

C) Huamarrësi, i cili është i bindur në realizimin dhe përparësitë e projektit të përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje, i kërkon Shoqatës ndihmë për financimin e projektit;

D) Huamarrësi mendon të lidhë një kontratë me Shoqatën, e cila vepron në cilësinë e administratorit në emër të Qeverisë së Japonisë, për një grant (Granti japonez) në një shumë të përgjithshme principi ekuivalente me dy milionë e dyqind e tridhjetë mijë dollarë (2 230 000 USD) për të ndihmuar në financimin e projektit sipas kushteve të përcaktuara në një marrëveshje që do të lidhet midis Huamarrësit dhe Shoqatës, e cila vepron në cilësinë e administratorit të fondeve grant të akorduara nga Qeveria e Japonisë (Marrëveshja për grantin japonez nga Fondet Trust);

E) Huamarrësi mendon të lidhë një kontratë me Shoqatën, e cila vepron në cilësinë e administratorit në emër të Komunitetit Europian, për një grant (Granti i KE-së) në një shumë të përgjithshme principi ekuivalente me pesë milionë e dyqind mijë dollarë (5 200 000 USD) për të ndihmuar në financimin e projektit sipas kushteve të përcaktuara në një marrëveshje që do të lidhet midis Huamarrësit dhe Shoqatës, e cila vepron në cilësinë e administratorit të fondeve grant të akorduara nga Komunitetet Europiane (Marrëveshja për grantin e KE-së nga Fondet Trust);

F) Huamarrësi mendon të lidhë kontratë me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), e cila vepron në kapacitetin e saj si agjenci zbatuese (Agjencia zbatuese) e Fondit Global për Mjedisin (FMG) për fondet grant të kontribuara në Fondin Trust të FMG-së nga anëtarë të caktuar të Bankës si pjesëmarrës në FMG, për një grant në shumën prej nëntëqind e pesëdhjetë mijë dollarë (950 000 USD) (Granti i

FMG), për të ndihmuar në financimin e një pjese të projektit sipas kushteve të përcaktuara në një marrëveshje, që do të lidhet midis Huamarrësit dhe Agjencisë zbatuese (Marrëveshja e grantit të FMG-së nga Fondet Trust);

G) Huamarrësi mendon të lidhë kontratë me Shoqatën, e cila vepron me cilësinë e administratorit në emër të Qeverisë së Holandës për një grant (Granti holandez) në një shumë të përgjithshme principali ekuivalente me tre milionë e njëqind e trembëdhjetë mijë dollarë (3 113 000 USD) për të ndihmuar në financimin e një pjese të projektit sipas kushteve të përcaktuara në një marrëveshje që do të lidhet midis Huamarrësit dhe Shoqatës, e cila vepron me cilësinë e administratorit të fondeve grant të akorduara nga Qeveria e Holandës (Marrëveshja për grantin holandez nga Fondet Trust);

H) Huamarrësi synon të kontrakttojë nga Shoqata, që vepron si administrator i Qeverisë së Austrisë, një grant (Granti austriak) me një vlef të agreguar principali të barasvlefshme me dy milionë e gjashtëqind mijë dollarë (2 600 000 \$) për të ndihmuar në financimin e një marrëveshjeje që do të lidhet midis Huamarrësit dhe Shoqatës, që vepron si administratore e fondeve në formë granti të dhëna nga Qeveria e Austrisë (Marrëveshja për grantin austriak të Fondit të Besimit).

Duke u bazuar në sa më sipër, Shoqata merr përsipër, ndër të tjera, t'i akordojë Huamarrësit, kredinë në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Për arsyet e mësipërme, palët e kësaj Marrëveshjeje bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Kushte të përgjithshme; përkufizime

Seksioni 1.01 “Kushtet e përgjithshme të aplikueshme për Marrëveshjen e kredisë për zhvillim” të akorduar nga Shoqata, e cila mban datën 1 janar 1985 (e ndryshuar deri në 1 maj 2004), së bashku me ndryshimet e përcaktuara më poshtë (Kushtet e përgjithshme), janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje:

a) Seksioni 5.08 i kushteve të përgjithshme ndryshohet si më poshtë:

“Seksioni 5.08 Trajtimi i tatimeve/taksave

Përveç rasteve kur në Marrëveshjen e kredisë për zhvillim parashikohet ndryshe, fondet e kredisë mund të tërhiqen për të paguar detyrimet tatimore të vendosura nga, apo të aplikuar në territorin e Huamarrësi(t) mbi mallrat apo shërbimet që do të financohen në kuadrin e kredisë apo mbi importimin, prodhimin, prokurimin apo furnizimin e tyre. Financimi i këtyre detyrimeve tatimore do të bëhet në përputhje me politikën e Shoqatës mbi kërkesat për ekonomizim dhe efikasitet në përdorimin e fondeve të kredive të saj. Për këtë qëllim, në të gjitha rastet kur Shoqata çmon se shumica e detyrimeve tatimore të vendosura mbi, apo në lidhje me, një artikull që do të financohet nga fondet e kredisë është shumë e lartë apo e paarsyeshme, Shoqata ka të drejtë që, mbasi të lajmërojë Huamarrësin, të ndryshojë përqindjen e shumës së kërkuar për artikullin në fjalë në Marrëveshjen e kredisë për zhvillim sipas kriterëve përkatës për respektimin e politikave të Shoqatës.”

b) Seksioni 6.03 (c) i kushteve të përgjithshme ndryshohet duke zëvendësuar fjalët “i korruptuar apo mashtrues” me fjalët “i korruptuar apo mashtrues, konfliktues apo shtrëngues”.

c) Paragrafi (c) i seksionit 9.06 të kushteve të përgjithshme ndryshohet si më poshtë:

“c) Huamarrësi ka detyrim që jo më vonë se gjashtë muaj nga data e mbylljes apo nga një datë e mëvonshme që caktohet për këtë qëllim me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës, të përgatisë dhe t'i paraqesë Shoqatës, në një formë dhe përmbajtje të kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Shoqata, një raport mbi zbatimin dhe operimin fillestar të projektit, kostot e tij dhe përfitimet e arritura apo që parashikohet të arrihen nga projekti, përmbushjen nga Huamarrësi dhe Shoqata të detyrimeve të tyre përkatëse në bazë të Marrëveshjes për kredi zhvillimi dhe arritjen e qëllimeve të kredisë.”

Seksioni 1.02 Përveç rasteve kur konteksti është i ndryshëm, kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në kushtet e përgjithshme dhe në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje do t'u jepet kuptimi përkatës i përcaktuar aty, ndërsa kushteve të mëposhtme shtesë do t'u jepet kuptimi si më poshtë:

a) Me termin “Përfituesi” apo “Përfituesit” kuptohen entet publike dhe njësi të qeverisjes vendore, si fshatrat, komunat apo bashkitë, si dhe shoqatat vendore, shkollat dhe pronarët e shtëpive në fshatrat tradicionalë, të cilët do të përfitojnë prej nënprojekteve të pjesës B.3(a) të projektit;

b) Me termin “Programi i ruajtjes dhe zhvillimit të fshatit bregdetar” kuptohet programi i vendosur në MRRTT, i përkufizuar në këtë Marrëveshje, në bazë të të cilit u akordohet përfituesve mbështetje financiare apo e llojeve të tjera për zbatimin e nënprojekteve;

c) Me termin “Kategori të kualifikueshme” kuptohen kategoritë nga (1) deri tek (8), të përcaktuara në tabelën e aneksit A.1 të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje;

d) Me termin “Shpenzime të kualifikueshme” kuptohen shpenzimet për mallra, punime dhe shërbime, të përcaktuara në seksionin 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

e) Me termin “Kudri i masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale” apo “KAMMS” kuptohet dokumenti i përgatitur nga Huamarrësi që i paraqitet Shoqatës më 4 prill 2005, sipas ndryshimeve të bëra më 20 prill 2005,

në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqatën, së bashku me ndryshimet që mund t'i bëhen herë pas here me pëlqimin e Shoqatës, në të cilin përcaktohen masat për minimizimin dhe zbutjen e efekteve negative mjedisore dhe sociale të projektit mbi individët mundësisht të ndikuar, duke përfshirë edhe kuadrin e shpërnguljes së popullsisë për zonën e bregdetit jugor, masat për përballimin e efekteve të planit të propozuar të menaxhimit për Parkun Kombëtar të Butrintit, masat për zgjidhjen e problemeve të shpronësimeve dhe shpërnguljes së popullsisë, që vijnë si pasojë e investimeve për menaxhimin e mbetjeve solide në Sarandë, si dhe çështjet e shpronësimeve për qëllime publike që kanë të bëjnë me punimet civile që do të kryhen në kuadrin e programit të ruajtjes dhe zhvillimit të fshatit bregdetar;

f) Me termin “Raporti i monitorimit financiar” apo “RMF” kuptohet çdo raport i përpiluar në përputhje me seksionin 4.02 (a) të kësaj Marrëveshjeje;

g) Me termin “Vit fiskal” kuptohet periudha 12-mujore që fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor;

h) Me termin “Grant” kuptohet financimi i një nënprojekti, sipas përkufizimit të dhënë në këtë Marrëveshje, në bazë të pjesës B.4(a) të projektit dhe në përputhje me Manualin Operativ, të përkufizuara në këtë Marrëveshje;

i) Me termin “MBU” kuptohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit e Huamarrësit, dhe përfshin çdo pasardhës të saj;

j) Me termin “MKRS” kuptohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Huamarrësit, dhe përfshin çdo pasardhës të saj;

k) Me termin “MM” kuptohet Ministria e Mjedisit e Huamarrësit, dhe përfshin çdo pasardhës të saj;

l) Me termin “MEP” kuptohet Ministria e Ekonomisë dhe e Privatizimit e Huamarrësit, dhe përfshin çdo pasardhës të saj;

m) Me termin “MF” kuptohet Ministria e Financave e Huamarrësit, dhe përfshin çdo pasardhës të saj;

n) Me termin “MPVD” kuptohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit e Huamarrësit, dhe përfshin çdo pasardhës të saj;

o) Me termin “MRRTT” kuptohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit e Huamarrësit, dhe përfshin çdo pasardhës të saj;

p) Me termin “MTT” kuptohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit e Huamarrësit, dhe përfshin çdo pasardhës të saj;

q) Me termin “Manuali Operativ” apo “MO” kuptohen Manuali Operativ për Fondin e Granteve të Vogla për Parkun Kombëtar të Butrintit dhe për Programin e Granteve të Vogla për përmirësimin e infrastrukturës në kuadrin e programit të ruajtjes dhe zhvillimit të fshatit bregdetar të përmendur në seksionin 6.01(b) të kësaj Marrëveshjeje, të pranueshme nga Shoqata dhe të adoptuara nga Huamarrësi, në të cilat përcaktohen procedurat operative dhe administrative për zbatimin e pjesës B.4(a) të projektit, së bashku me ndryshimet që mund të bëhen herë pas here me marrëveshje midis Shoqatës dhe Huamarrësit;

r) Me termin “PAP” apo “Personi autorizues i projektit” kuptohet zëvendësministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit, i ngarkuar nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit i Huamarrësit me detyrën e mbikëqyrjes së punimeve të NJKP, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Marrëveshje;

s) Me termin “NJKP” apo “Njësia e koordinimit të projektit” kuptohet njësia brenda MRRTT-së e ngarkuar me detyrën e koordinimit të përgjithshëm të projektit;

t) Me termin “PIP” apo “Plani i zbatimit të projektit” kuptohet plani i përcaktuar në paragrafin (3) të shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje, i pranueshëm nga Shoqata dhe i adoptuar nga Huamarrësi, më 23 prill 2005, në të cilin përcaktohen procedurat operative dhe administrative për zbatimin e projektit, së bashku me ndryshimet që mund t'i bëhen herë pas here me marrëveshje midis Shoqatës dhe Huamarrësit;

u) Me termin “KDP” apo “Komisioni drejtues i projektit” kuptohet komisioni ndërminstor që do të emërohet nga Këshilli i Ministrave i Huamarrësit, i kryesuar nga një zëvendësministër i MRRTT-së dhe që do të ketë në përbërje të tij anëtarë nga MF, MEP, MTT, MKRS, MBU dhe MPVD, si dhe përfaqësues nga pushtetet rajonale dhe vendore dhe nga organizatat joqeveritare;

v) Me termin “Plan prokurimi” kuptohet plani i prokurimeve të Huamarrësit, që mban datën 15 prill 2005, i cili mbulon të gjithë periudhën e zbatimit të projektit, së bashku me ndryshimet që mund t'i bëhen herë pas here në përputhje me dispozitat e seksionit 3.02 të kësaj Marrëveshjeje;

w) Me termin “Parapagim për përgatitjen e projektit” kuptohet shuma e parapaguar për përgatitjen e projektit, e akorduar nga Shoqata për Huamarrësin në bazë të letrës marrëveshje të nënshkruar në emër të Shoqatës më 3 gusht 2004 dhe në emër të Huamarrësit më 4 nëntor 2004;

x) Me termin “Disbursime me bazë raportesh” kuptohet e drejta e Huamarrësit për tërheqjen e fondeve nga llogaria e kredisë, e përcaktuar në aneksin A.5 të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje;

y) Me termin “Plani i shpërnguljes” kuptohet plani i datës 4 prill, i ndryshuar më 20 prill 2005, i cili është integruar dhe paraqitur si pjesë përbërëse e KMMMS, për shpërnguljen e katër familjeve të zonës së Porto Romanos, i përpiluar dhe për t'u zbatuar nga Ministria e Mjedisit e Huamarrësit;

z) Me termin “Plani i zhvillimit të bregdetit jugor” kuptohet plani i përdorimit të tokës dhe i përcaktimit të vijave të verdha që do të përpilohet në bazë të pjesës A.2(f) të projektit dhe do të adoptohet nga

Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit i Huamarrësit, në të cilin përcaktohet kuadri i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, në përputhje me konceptet e vlerësimit mjedisor dhe kriteret e masave mbrojtëse sociale për drejtimin e investimeve të ardhshme në zonën e bregdetit jugor;

aa) Me termin “Llogari e posaçme” kuptohet llogaria e përmendur në aneksin B të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje;

bb) Me termin “Nënprojekt” kuptohen projektet e zhvillimit të përzgjedhura në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në Manualin Operativ, nëpërmjet përdorimit të fondeve të një granti të akorduar në kuadrin e pjesës B.4(a) të projektit dhe prej të cilave do të përfitojnë përfituesit.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01 Shoqata merr përsipër t'i japë kredi Huamarrësit mbi bazën e kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, në një shumë të përbërë nga monedha të ndryshme ekuivalente me njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë të drejta të posaçme tërheqjeje (SDR 11 700 000).

Seksioni 2.02 (a) Shuma e kredisë mund të tërhiqet nga llogaria e kredisë në përputhje me dispozitat e shtesës 1 të kësaj Marrëveshjeje për: (i) shumat e paguara (apo që do të paguheshin me pëlqimin e shoqatës nga Huamarrësi për mbulimin e tërheqjeve të bëra nga ose për përfituesit në kuadrin e një granti për përballimin e kostove të arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të nevojshme për pjesën B.4 (a) të projektit, për të cilat kërkohet tërheqja e fondeve nga llogaria e kredisë; dhe (ii) për shpenzimet e bëra (apo që do të bëhen me pëlqimin e shoqatës) për përballimin e kostove të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të nevojshme për projektin dhe që do të financohen nga fondet e kredisë.

b) Menjëherë mbas datës së hyrjes në fuqi, shoqata do të tërheqë nga llogaria e kredisë në emër të Huamarrësit dhe do t'i paguajë vetes së saj shumën e nevojshme kthimin e shumës principal të parapagimit për përgatitjen e projektit, që është tërhequr dhe duhet paguar në këtë datë, si dhe për të paguar të gjitha tarifatat e papaguara që lidhen me të. Balanca e patërhequr e shumës së autorizuar si parapagim për përgatitjen e projektit do të anulohet.

Seksioni 2.03 Data e mbylljes do të jetë 31 mars 2010 ose një datë e mëvonshme që do të caktohet nga Shoqata. Shoqata do të lajmërojë menjëherë Huamarrësin në rast caktimi të një date të mëvonshme.

Seksioni 2.04 (a) Huamarrësi merr përsipër që për çdo shumë principal të kredisë që herë pas here do të mbetet e patërhequr t'i paguajë Shoqatës një tarifë angazhimi në një përqindje që do të caktohet nga Shoqata më 30 qershor të çdo viti, por që nuk do të jetë më e lartë se gjysmë për qind (1/2 e 1%) në vit.

b) Tarifa e angazhimit do të fillojë të akumulohet duke filluar: (i) nga data që bie gjashtëdhjetë ditë mbas datës së Marrëveshjes (data e akumulimit) deri në datat përkatëse në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga llogaria e kredisë apo do të anulohen; dhe (ii) në një përqindje të përcaktuar më datën 30 qershor që vjen menjëherë mbas datës së akumulimit dhe në përqindje të tjera që do të përcaktohen herë pas here mbas asaj date në bazë të paragrafit (a) më sipër. Përqindja e përcaktuar më datën 30 qershor të çdo viti do të aplikohet duke filluar që nga dita e mëpasshme e po atij viti, sipas përcaktimeve të parashikuara në seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Tarifa e angazhimit duhet të paguhet: (i) në vendin e caktuar në mënyrë të arsyeshme nga Shoqata; (ii) pa asnjë lloj kufizimi të vendosur nga, apo në territorin e, Huamarrësi(t); dhe (iii) në monedhën e caktuar në këtë Marrëveshje për qëllime të seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme apo në ndonjë monedhë tjetër, apo monedha të tjera të përshtatshme që mund të caktohen, apo zgjidhen herë pas here në përputhje me dispozitat e atij seksioni.

Seksioni 2.05 Huamarrësi merr përsipër që, për çdo shumë principal të kredisë së tërhequr dhe të papërdorur herë pas here t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi në masën prej tre të katërtave për qind (3/4 të 1%) në vit.

Seksioni 2.06 Tarifatat e angazhimit dhe të shërbimit duhet të paguheshin çdo gjashtë muaj më 15 mars dhe më 15 shtator të çdo viti.

Seksioni 2.07 Huamarrësi merr përsipër të kthejë shumën principal të kredisë në këste gjashtëmuajore, që do të paguheshin çdo 15 mars dhe 15 shtator duke filluar më 15 shtator 2015 dhe duke mbaruar më 15 mars 2025. Çdo këst do të paguhet në shumën prej pesë për qind (5%) të shumës përkatëse të principalit.

Seksioni 2.08 Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është monedha që do të përdoret për qëllime të seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme.

Neni 3

Zbatimi i projektit

Seksioni 3.01 a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për arritjen e objektivave të projektit të përcaktuar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe për këtë qëllim merr përsipër të zbatojë projektin me kujdes

dhe efikasitet dhe në përputhje me praktikat e përshtatshme administrative, financiare, mjedisore, bregdetare dhe bujqësore, si dhe të sigurojë menjëherë sipas nevojave fondet, mjetet, shërbimet dhe burimet e tjera të nevojshme për projektin.

b) Pa kufizime ndaj dispozitave të paragrafit (a) të këtij seksioni dhe me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata do të bien dakord për të kundërtën, Huamarrësi merr përsipër të zbatojë projektin në përputhje me programin e zbatimit të përcaktuar në shtesën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Pa kufizime ndaj dispozitave të paragrafit (a) të këtij seksioni dhe me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata do të bien dakord për të kundërtën, Huamarrësi merr përsipër që duke filluar nga viti fiskal 2006 të rishikojë bashkë me shoqatën, brenda datës 30 shtator të çdo viti, dispozitat për fondet homologe të nevojshme për zbatimin e projektit gjatë vitit të ardhshëm fiskal dhe të akordojë fonde të përshtatshme për këtë qëllim në buxhetin shtetëror të Huamarrësit për vitin e ardhshëm fiskal.

Seksioni 3.02 a) Me përjashtim të rasteve kur shoqata bie dakord për të kundërtën, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të nevojshme për projektin, të cilat do të financohen nga fondet e kredisë, do të rregullohet nga dispozitat e shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje, dispozita të cilat mund të përpunohen më tej në planin e prokurimeve.

b) Huamarrësi merr përsipër të azhurnojë planin e prokurimeve në përputhje me kritere të pranueshme për shoqatën dhe t'i paraqesë Shoqatës për aprovim ndryshimet përkatëse brenda 12 muajve nga data e planit të mëparshëm të prokurimeve.

Seksioni 3.03 Për qëllime të seksionit 9.06 të kushteve të përgjithshme dhe pa ndonjë kufizim ndaj tyre, Huamarrësi merr përsipër që:

a) mbi bazën e kritereve të pranueshme për Shoqatën, të përgatisë një plan për operimin e ardhshëm të projektit dhe t'ia paraqesë Shoqatës jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga data e mbylljes apo nga një datë e mëvonshme, që do të përcaktohet për këtë qëllim me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës; dhe

b) t'i japë Shoqatës mundësi të arsyeshme për ta diskutuar këtë plan me Huamarrësin.

Neni 4

Dispozita financiare

Seksioni 4.01 a) Huamarrësi merr përsipër të përdorë një sistem menaxhimi financiar, i cili të përfshijë dokumentacionin dhe llogaritë, si dhe të përpilojë deklarata financiare të përshtatshme për pasqyrimin e operacioneve, burimeve dhe shpenzimeve të kryera për projektin, në përputhje me standarde kontabiliteti të aplikuara në mënyrë konstante dhe të pranueshme për Shoqatën.

b) Huamarrësi merr përsipër:

i) të lejojë kryerjen e kontrollit financiar të deklaratave financiare të përmendura në paragrafin (a) të këtij seksioni nga ekspertë të pavarur të pranueshëm për Shoqatën për çdo vit fiskal (apo periudhë tjetër për të cilën është rënë dakord me Shoqatën) në përputhje me standarde kontrolli financiar të aplikuara në mënyrë konstante dhe të pranueshme për Shoqatën;

ii) t'i paraqesë Shoqatës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj mbas përfundimit të çdo viti fiskal (apo një periudhë tjetër për të cilën është rënë dakord me Shoqatën) (A) kopje të vërtetuara të deklaratave financiare të përmendura në paragrafin (a) të këtij seksioni për vitin fiskal përkatës (apo një periudhë tjetër për të cilën është rënë dakord me Shoqatën) në të cilat vërtetohet kryerja e kontrollit financiar dhe (B) mendimin e ekspertëve mbi këto deklarata, të paraqitura në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqatën;

iii) t'i paraqesë Shoqatës, në çdo rast që kjo e konsideron të arsyeshme, çdo informacion tjetër që ka të bëjë me dokumentacionin dhe llogaritë, dhe me kontrollin e kryer mbi këto deklarata financiare apo ekspertët e kontrollit financiar.

c) Huamarrësi merr përsipër që për çdo shpenzim të kryer, i cili është mbuluar nëpërmjet fondeve të tërhequra nga llogaria e kredisë mbi bazën e raporteve të përmendura në pjesën A.5 të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje (disbursime me bazë raportesh) apo në deklaratat e shpenzimeve:

i) të ruajë të gjithë dokumentacionin që evidenton këto shpenzime (kontrata, porosi, fatura, vërtetime pagesash dhe dokumente të tjera) për një periudhë prej të paktën një viti mbas datës së paraqitjes të Shoqata të raportit të kontrollit financiar për, apo që mbulon vitin fiskal, në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga llogaria e kredisë;

ii) të bëjë të mundur shqyrtimin e këtij dokumentacioni nga përfaqësuesit e Shoqatës;

iii) të sigurohet që këto raporte dhe deklarata shpenzimesh të përfshihen në kontrollin financiar për çdo vit fiskal (apo një periudhë tjetër për të cilën është rënë dakord me Shoqatën) të përmendur në paragrafin (b) të këtij seksioni.

Seksioni 4.02 a) Pa kufizime ndaj punës së bërë nga Huamarrësi për përmbushjen e detyrimeve të raportimit të përcaktuara në paragrafin 7 të shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi merr përsipër të përgatisë dhe t'i paraqesë Shoqatës një raport të monitorimit financiar, në një formë dhe përmbajtje të

pranueshme për Shoqatën, në të cilin:

i) pasqyrohen burimet dhe përdorimi i fondeve të projektit, si në mënyrë akumulative ashtu dhe për periudhën e mbuluar nga raporti, duke bërë pasqyrimin veç e veç të fondeve të përfuara në kuadrin e kredisë dhe duke dhënë shpjegime ndryshimet midis përdorimit aktual dhe atij të planifikuar të këtyre fondeve;

ii) pasqyrohet përparimi i bërë në zbatimin e projektit, si në mënyrë akumulative ashtu dhe për periudhën e mbuluar nga raporti, duke shpjeguar ndryshimet midis përparimit aktual dhe atij të planifikuar për zbatimin e projektit;

iii) pasqyrohet statusi i prokurimeve në kuadrin e projektit në fund të periudhës së mbuluar nga raporti në fjalë.

b) RMF i parë i paraqitet shoqatës brenda 45 ditëve nga fundi i tremujorit të parë kalendarik mbas datës së hyrjes në fuqi dhe duhet të mbulojë periudhën nga kryerja e shpenzimit të parë për projektin deri në fund të 3-mujorit kalendarik në fjalë; më pas, çdo RMF i paraqitet Shoqatës brenda 45 ditëve, nga fundi i çdo tremujori pasardhës kalendarik dhe mbulon tremujorin kalendarik që përfundoi.

Neni 5

Mbrojtjet ligjore të Shoqatës

Seksioni 5.01 Ngjarjet e mëposhtme shtesë përcaktohen në përputhje me seksionin 6.02 (l) të kushteve të përgjithshme:

a) Deri në 31 mars 2006 apo në një datë të mëvonshme për të cilën është rënë dakord me shoqatën, nuk është lidhur marrëveshja për grantin e KE-së nga Fondet Trust apo nuk është përmbushur ndonjë kusht paraprak për hyrjen e saj në fuqi, apo për hyrjen në fuqi të së drejtës së Huamarrësit për tërheqje fondesh në bazë të asaj marrëveshjeje; megjithatë dispozitat e këtij paragrafi nuk aplikohen kur Huamarrësi provon në mënyrë bindëse për Shoqatën se ka në dispozicion të tij fonde të përshtatshme për projektin nga burime të tjera të akorduara në bazë të kushteve kontraktuale që nuk bien në kundërshtim me detyrimet e Huamarrësit të rrjedhura nga kjo Marrëveshje.

b) Deri në 31 dhjetor 2005 apo në një datë të mëvonshme për të cilën është rënë dakord me Shoqatën, nuk është lidhur marrëveshja për grantin japonez nga Fondet Trust apo nuk është përmbushur ndonjë kusht paraprak për hyrjen e saj në fuqi, apo për hyrjen në fuqi të së drejtës së Huamarrësit për tërheqje fondesh në bazë të asaj marrëveshjeje; megjithatë dispozitat e këtij paragrafi nuk aplikohen kur Huamarrësi provon në mënyrë bindëse për Shoqatën se ka në dispozicion të tij fonde të përshtatshme për projektin nga burime të tjera të akorduara në bazë të kushteve kontraktuale që nuk bien në kundërshtim me detyrimet e Huamarrësit të rrjedhura nga kjo Marrëveshje.

c) Deri në 31 mars 2006 apo në një datë të mëvonshme për të cilën është rënë dakord me shoqatën, nuk është lidhur marrëveshja për grantin austriak nga Fondet Trust apo nuk është përmbushur ndonjë kusht paraprak për hyrjen e saj në fuqi, apo për hyrjen në fuqi të së drejtës së Huamarrësit për tërheqje fondesh në bazë të asaj marrëveshjeje; megjithatë dispozitat e këtij paragrafi nuk aplikohen kur Huamarrësi provon në mënyrë bindëse për shoqatën se ka në dispozicion të tij fonde të përshtatshme për projektin nga burime të tjera të akorduara në bazë të kushteve kontraktuale që nuk bien në kundërshtim me detyrimet e Huamarrësit të rrjedhura nga kjo Marrëveshje.

d) Deri në 31 dhjetor 2005 apo në një datë të mëvonshme për të cilën është rënë dakord me Shoqatën, nuk është lidhur marrëveshja për grantin e FMG-së nga Fondet Trust apo nuk është përmbushur ndonjë kusht paraprak për hyrjen e saj në fuqi apo për hyrjen në fuqi të së drejtës së Huamarrësit për tërheqje fondesh në bazë të asaj marrëveshjeje; megjithatë dispozitat e këtij paragrafi nuk aplikohen kur Huamarrësi provon në mënyrë bindëse për Shoqatën se ka në dispozicion të tij fonde të përshtatshme për projektin nga burime të tjera të akorduara në bazë të kushteve kontraktuale që nuk bien në kundërshtim me detyrimet e Huamarrësit të rrjedhura nga kjo Marrëveshje.

e) (i) Në varësi të nënparagrafit (ii) të këtij paragrafi, të jetë pezulluar, anuluar apo përfunduar, tërësisht apo pjesërisht, në bazë të kushteve të marrëveshjes për grantin e KE-së nga Fondet Trust, marrëveshjes për grantin japonez nga Fondet Trust, marrëveshjes për grantin e FMG-së nga Fondet Trust, apo marrëveshjes për grantin holandez apo grantin austriak nga Fondet Trust përkatësisht, e drejta e Huamarrësit për tërheqjen e fondeve të akorduara për financimin e projektit nga granti i KE-së, granti japonez, granti i GEF, granti austriak apo granti holandez përkatësisht.

ii) Nënparagrafi (i) i këtij paragrafi nuk do të aplikohet kur Huamarrësi vërteton në mënyrë të pranueshme për Shoqatën se: (A) pezullimi, anulimi apo përfundimi i përmendur më sipër nuk është shkaktuar nga mospërmbushja nga ana e Huamarrësit i detyrimeve të marra përsipër në bazë të marrëveshjes për grantin e KE-së nga Fondet Trust, marrëveshjes për grantin japonez nga Fondet Trust, marrëveshjes për grantin e FMG-së nga Fondet Trust, Marrëveshjes për grantin austriak nga Fondet Trust apo Marrëveshjes për grantin holandez nga Fondet Trust përkatësisht; dhe (B) Huamarrësi ka në dispozicion të tij fonde të përshtatshme për projektin nga burime të tjera të akorduara në bazë të kushteve kontraktuale që nuk bien në kundërshtim me detyrimet e

Huamarrësit të rrjedhura nga kjo Marrëveshje.

f) Huamarrësi nuk ka përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij të marra përsipër në bazë të marrëveshjes për grantin e KE-së nga Fondet Trust, marrëveshjes për grantin japonez nga Fondet Trust, marrëveshjes për grantin e FMG-së nga Fondet Trust, marrëveshjes për grantin austriak nga Fondet Trust apo marrëveshjes për grantin holandez nga Fondet Trust përkatësisht.

g) KMMMS, plani i shpërnguljes, plani i zbatimit të projektit apo manualët operative janë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar apo lënë mënjanë në mënyrë të tillë që, sipas mendimit të Shoqatës, sjell ndikime thelbësore negative mbi zbatimin e projektit.

h) Vërtetohet një situatë e tillë, e cila e bën të pamundur zbatimin e projektit apo një pjesë të konsiderueshme të tij.

Seksioni 5.02 Në përputhje me seksionin 7.01(h) të kushteve të përgjithshme, përcaktohen kushtet e mëposhtme shtesë, në bazë të të cilave kërkohet që çdo ngjarje, e përcaktuar në paragrafët (f) dhe (g) të seksionit 5.01 të kësaj marrëveshjeje, të vërtetohet dhe të vazhdojë për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh mbas lajmërimit që Shoqata i jep Huamarrësit për vërtetimin e ngjarjes në fjalë.

Neni 6

Data e hyrjes në fuqi; zgjidhja e marrëveshjes

Seksioni 6.01 Ngjarjet e mëposhtme përcaktohen si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së kredisë për zhvillim brenda kuptimit të seksionit 12.01(b) të kushteve të përgjithshme:

a) Të jetë lidhur marrëveshja për grantin holandez nga Fondet Trust dhe të jenë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara për hyrjen në fuqi të saj apo për hyrjen në fuqi të të drejtave të Huamarrësit për kryerjen e tërheqjeve të fondeve nën atë marrëveshje, me përjashtim vetëm të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së kredisë për zhvillim;

b) Të jenë adoptuar nga Huamarrësi Manualët Operative.

Seksioni 6.02 Data që bie nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së lidhjes së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet si data që do të përdoret për qëllime të seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7

Përfaqësuesi i Huamarrësit; adresat

Seksioni 7.01 Ministri i Financave i Huamarrësit ngarkohet me detyrën e përfaqësuesit të Huamarrësit për qëllime të seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02 Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllime të seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Faks: 355 42 28494

Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433, USA
Adresa a Kabllit:
INTBAFRAD
Washington, D.C. 64145 (MCI)
Teleks: 248423 (MCI)
Faks: (202) 477-6391

Palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruajnë këtë Marrëveshje me emrat e tyre përkatës _____, në datën dhe vitin e treguar më sipër.

SHQIPËRI
Nga Përfaqësuesi i autorizuar

SHOQATA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
Nga Përfaqësuesi i autorizuar

SHTOJCA 1

TËRHEQJA E FONDEVE TË KREDISË

A. Të përgjithshme

1. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e artikujve që do të financohen me fondet e kredisë, alokimin e shumave të kredisë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për artikujt që do të financohen në këtë mënyrë për çdo kategori:

Kategoria	Shuma e alokuar e kredisë (e shprehur në ekuivalent të SDR)	% e shpenzimeve që do të financohen
1. Mallra	2 000 000	100%
2. Punime	3 450 000	80%
3. Grante për Pjesën B.4(a) të projektit	2 960 000	80%
4. Shërbime inxhinierike	1 160 000	100%
5. Shërbime konsulence	500 000	100%
6. Trainime	150 000	100%
7. Kosto operative akumulative	290 000	100%
8. Kthimi i parapagimit për përgatitjen e projektit	1 000 000	Shumë për t'u paguar sipas seksionit 2.02(b) të kësaj Marrëveshjeje
9. Të paalokuara	190 000	
Total	11 700 000	

2. Për qëllime të kësaj shtojce:

a) Me termin “Kosto operative akumulative” kuptohen shpenzimet akumulative të arsyeshme dhe të nevojshme të aprovuara nga Shoqata mbi bazën e buxheteve të pranueshme për Shoqatën, të cilat nuk do të bëheshin pa ekzistencën e projektit dhe që përfshijnë, ndër të tjera, kostot për: (i) mirëmbajtjen dhe operimin e pajisjeve të prokuruar apo të përdorura për menaxhimin e projektit; (ii) pagat e paguara për stafin e punësuar për qëllime të projektit, përveç pagave të punonjësve të shërbimit civil; (iii) kostot e udhëtimeve dhe dietat e paguara për stafin e punësuar për qëllime të projektit; dhe (iv) pajisjet e konsumueshme të zyrës;

b) me termin “Trajnime” kuptohen shpenzimet e bëra nga Huamarrësi për kryerjen e aktiviteteve të trajnimit, vizita studimore dhe seminare në kuadrin e projektit, ku përfshihen kostot e udhëtimit dhe dietat për pjesëmarrësit vendas në trajnime, instruktorët dhe pjesëmarrësit, qiraja e ambienteve dhe pajisjeve, si dhe materialet dhe mjetet e tjera të trajnimit;

c) Me termin “Shërbime inxhinierike” kuptohen shpenzimet e bëra për mbulimin e kostove të rilevimit, studimeve të fizibilitetit, projekteve dhe supervizionit të punimeve.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk mund të bëhet për të mbuluar shpenzime të kryera përpara datës së kësaj Marrëveshjeje.

4. Shoqata ka të drejtë të kërkojë që tërheqjet nga llogaria e kredisë të bëhen mbi bazën e deklaratave të shpenzimeve për ato shpenzime që kanë të bëjnë me kontrata për: a) mallra me një vlerë të përgjithshme më të vogël se ekuivalenti prej 100 000 USD për kontratë; b) punime me kosto më të ulët se ekuivalenti prej 200 000 USD për kontratë; c) shërbime konsulence individuale me kosto më të ulët se ekuivalenti prej 50 000 USD për kontratë; d) shërbime konsulence nga firma konsulence me kosto më të ulët se ekuivalenti prej 100 000 USD për kontratë; dhe e) të gjitha grantet e pjesës B.4 (a) të projektit, të cilat do të kryhen në bazë të kushteve të përcaktuara nga Shoqata për të cilat Huamarrësit i dërgohet lajmërim.

5. Huamarrësi ka të drejtë që nga momenti i marrjes së një lajmërimi me shkrim nga Shoqata për këtë qëllim, të kërkojë që tërheqja e fondeve nga llogaria e kredisë të bëhet mbi bazën e raporteve që do t'i paraqiten Shoqatës në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqatën. Raportet duhet të përfshijnë RMF dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Shoqata me shkrim (disbursime me bazë raportesh). Në rastin e kërkesës së parë të këtij lloji, e cila i paraqitet Shoqatës kur nuk është bërë asnjë tërheqje nga llogaria e kredisë, Huamarrësi i paraqet Shoqatës një deklaratë ku përcaktohen burimet dhe përdorimi i parashikuar i fondeve për projektin për një periudhë prej gjashtë muajsh pas datës së paraqitjes së kërkesës.

B. Llogaria e posaçme

1. Huamarrësi ka të drejtë të hapë dhe të mbajë në dollarë një llogari të posaçme depozite në një bankë dhe me kushte të pranueshme për Shoqatën, të cilat të përfshijnë edhe mbrojtje të përshtatshme ndaj çdo të drejte kompensimi, sekuestroje apo konfiskimi.

2. Pas marrjes nga Shoqata të dokumentacionit të pranueshëm për të, nëpërmjet të cilit vërtetohet hapja e llogarisë së posaçme, tërheqja nga llogaria e kredisë e shumave për depozitim në llogarinë e posaçme bëhet si më poshtë:

a) në rast se Huamarrësi nuk bën disbursime me bazë raportesh, tërheqjet bëhen në përputhje me dispozitat e aneksit A të kësaj shtojce 1;

b) në rast se Huamarrësi bën disbursime me bazë raportesh, tërheqjet do të bëhen në përputhje me dispozitat e aneksit B të kësaj shtojce 1.

3. Pagesat nga llogaria e posaçme bëhen në mënyrë ekskluzive vetëm për shpenzime të kualifikueshme

për këto lloj pagesash. Huamarrësi është i detyruar që për çdo pagesë të kryer nga ai nëpërmjet llogarisë së posaçme, t'i paraqesë Shoqatës, në çdo rast që kjo e çmon të arsyeshme të kërkojë, prova dokumentare apo të ndonjë lloji tjetër që vërtetojnë kryerjen e pagesave ekskluzivisht vetëm për shpenzime të kualifikueshme.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 të aneksit B të kësaj shtojce, Shoqata nuk ka asnjë detyrim të bëjë depozitime të mëtejshme në llogarinë e posaçme:

a) në rast se Shoqata, në çdo kohë, nuk është e bindur që raportet e përmendura në paragrafin 5 të aneksit A të kësaj shtojce nr.1 përmbajnë informacion të mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e disbursimeve me bazë raportesh;

b) në rast se Shoqata vendos, në çdo kohë, se të gjitha tërheqjet e mëtejshme për pagesat e shpenzimeve të kualifikueshme duhet të bëhen nga Huamarrësi drejtpërdrejt nga llogaria e kredisë; apo

c) në rast se Huamarrësi nuk përmbush detyrimin e tij për t'i paraqitur Shoqatës brenda afatit të përcaktuar në seksionin 4.01(b)(ii) të kësaj Marrëveshjeje raportet e kontrollit financiar, të cilat duhet t'ia paraqesë Shoqatës në përputhje me seksionin e sipërpërmendur për kontrollin e kryer mbi: A) dokumentacionin dhe llogaritë për llogarinë e posaçme; apo B) dokumentacionin dhe llogaritë që pasqyrojnë ato shpenzime për të cilat tërheqjet janë bërë ose në formën e disbursimeve me bazë raportesh ose mbi bazën e deklaratave të shpenzimeve, sipas rastit.

5. Shoqata nuk ka asnjë detyrim të bëjë depozitime të mëtejshme në llogarinë e posaçme në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 të aneksit B të kësaj shtojce në rast se, në çdo kohë, Shoqata ka lajmëruar Huamarrësin për vendimin e saj në lidhje me pezullimin e plotë apo të pjesshëm të së drejtës së Huamarrësit për kryerjen e tërheqjeve nga llogaria e kredisë në përputhje me seksionin 6.02 të kushteve të përgjithshme. Që në momentin e marrjes nga Huamarrësi të lajmërimit, Shoqata ka të drejtë të vendosë, sipas gjykimit të saj, nëse do të bëjë apo jo depozitime të mëtejshme në llogarinë e posaçme dhe se cilat procedura do të ndiqen për kryerjen e këtyre depozitave, duke lajmëruar Huamarrësin për vendimin e saj.

6. a) Në të gjitha rastet, kur Shoqata çmon, në çdo kohë, që një pagesë e kryer nëpërmjet llogarisë së posaçme është bërë për një shpenzim jo të kualifikueshëm, apo nuk justifikohet nga dokumentacioni i paraqitur pranë Shoqatës, Huamarrësi është i detyruar që menjëherë mbas marrjes së lajmërimit nga Shoqata, të paraqesë çdo dokumentacion shtesë të kërkuar nga Shoqata apo të depozitojë në llogarinë e posaçme (apo në rast se kërkohej nga Shoqata t'i kthejë Shoqatës) një shumë të barabartë me shumën e pagesës së kryer. Me përjashtim të rasteve kur Shoqata bie dakord për të kundërtën, depozitimet e Shoqatës në llogarinë e posaçme do të ndërpriten deri në momentin që Huamarrësi paraqet dokumentacionin e kërkuar, ose bën depozitim apo kthimin e shumës, sipas rastit.

b) Në të gjitha rastet kur Shoqata çmon, në çdo kohë, që një shumë e papërdorur në llogarinë e posaçme nuk do të nevojitet për mbulimin e pagesës së një shpenzimi të kualifikueshëm brenda periudhës prej gjashtë muajsh nga ky përcaktim i saj, Huamarrësi është i detyruar që menjëherë mbas marrjes së lajmërimit nga Shoqata t'i kthejë Shoqatës shumën e papërdorur.

c) Huamarrësi mund të vendosë t'i kthejë Shoqatës, tërësisht apo pjesërisht, fondet e depozituara në llogarinë e posaçme, mbasi të ketë lajmëruar më parë Shoqatën për këtë.

d) Shumat e kthyera Shoqatës në bazë të nënparagrafit (a), (b) apo (c) të këtij paragrafi nr.6 kreditohen në llogarinë e kredisë për tërheqje të mëvonshme apo për anulim në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

ANEKSI A I SHTOJCËS 1 FUNKSIONIMI I LLOGARISË SË POSAÇME KUR TËRHEQJET NUK JANË DISBURSIME ME BAZË RAPORTESH

1. Për qëllime të kësaj shtojce, me termin "Alokim i autorizuar" kuptohet shuma ekuivalente me 1 700 000 USD që do të tërhiqet nga llogaria e kredisë dhe do të depozitohet në llogarinë e posaçme në përputhje me paragrafin 2 të kësaj shtojce, me kusht që me përjashtim të rasteve kur Shoqata bie dakord për të kundërtën, alokimi i autorizuar kufizohet në një shumë ekuivalente me

1 000 000 USD deri sa shuma e përgjithshme e tërheqjeve nga llogaria e kredisë plus shumën totale të të gjitha fondeve të posaçme të papërdorura të dhëna nga Shoqata, në përputhje me seksionin 5.02 të kushteve të përgjithshme, do të jetë e barabartë apo më e madhe se sa shuma ekuivalente me 5 500 000 SDR

2. Tërheqjet e alokimeve të autorizuar dhe tërheqjet e mëpasshme për mbushjen e llogarisë së posaçme do të bëhen si më poshtë:

a) Për tërheqjet e alokimeve të autorizuar, Huamarrësi i paraqet Shoqatës një kërkesë apo kërkesa për depozitime në llogarinë e posaçme në një shumë apo shuma që së bashku nuk e kalojnë shumën e alokimit të autorizuar. Mbi bazën e këtyre kërkesave Shoqata tërheq në emër të Huamarrësit nga llogaria e kredisë shumat e kërkuara nga Huamarrësi dhe i depoziton këto në llogarinë e posaçme.

b) Për mbushjen e llogarisë së posaçme, Huamarrësi i paraqet Shoqatës kërkesa për depozitime në llogarinë e posaçme në intervale kohore të përcaktuara nga Shoqata. Përpara paraqitjes së kërkesës apo në

momentin e paraqitjes së saj, Huamarrësi i dorëzon Shoqatës dokumentacionin dhe evidencat përkatëse të përcaktuara në pjesën B.3 të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje për pagesën apo pagesat për të cilat kërkohet mbushja e llogarisë. Mbi bazën e kërkesave të paraqitura, Shoqata tërheq nga llogaria e kredisë në emër të Huamarrësit dhe depoziton në llogarinë e posaçme shumë e kërkuara nga Huamarrësi, të cilat vërtetohen nga dokumentacioni dhe evidencat përkatëse se janë paguar nga llogaria e posaçme për shpenzime të kualifikueshme. Çdo shumë e tillë e depozituar në llogarinë e posaçme, do të tërhiqet nga Shoqata nga llogaria e kredisë në bazë të kategorive të kualifikueshme përkatëse.

3. Shoqata nuk ka asnjë detyrim për kryerjen e depozitimeve të mëtejshme në llogarinë e posaçme që nga momenti që shuma totale e patërhequr e kredisë minus shumën totale të të gjitha fondeve të posaçme të papërdorura të dhëna nga Shoqata në përputhje me seksionin 5.02 të kushteve të përgjithshme të jetë e barabartë me dyfishin e shumës ekuivalente të alokimit të autorizuar. Që nga ky moment, tërheqja nga llogaria e kredisë e shumës së mbetur pa u tërhequr nga kredia do të kryhet në bazë të procedurave të përcaktuara nga Shoqata, për të cilat i dërgohet lajmërim Huamarrësit. Tërheqjet e mëpasshme do të kryhen vetëm mbasi, dhe në atë masë që Shoqata të jetë e bindur që të gjitha shumat e mbetura në llogarinë e posaçme që nga data e lajmërimit të dërguar do të përdoren për kryerjen e pagesave për shpenzime të kualifikueshme.

ANEKSI B I SHTOJCËS 1 FUNKSIONIMI I LLOGARISË SË POSAÇME KUR TËRHEQJET JANË DISBURSIME ME BAZË RAPORTESH

1. Shumat e tërhequra nga llogaria e kredisë depozitohen nga Shoqata në llogarinë e posaçme në përputhje me dispozitat e shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje. Çdo shumë e depozituar në llogarinë e posaçme tërhiqet nga Shoqata nga llogaria e kredisë në bazë të kategorive të kualifikueshme përkatëse.

2. Me marrjen e kërkesës për tërheqjen e një shume të caktuar nga kredia, Shoqata tërheq nga llogaria e kredisë në emër të Huamarrësit dhe depoziton në llogarinë e posaçme një shumë të barabartë me shumën më të vogël që përfaqëson: (a) shumën e kërkuar; apo (b) shumën e mjaftueshme për financimin e shpenzimeve të kualifikueshme gjatë periudhës gjashtë-mujore që pason paraqitjen e kërkesës, shumë kjo e përcaktuar nga Shoqata në bazë të raporteve të përmendura në pjesën A.5 të kësaj shtojce nr.1 dhe të aplikueshme për kërkesën e paraqitur për tërheqje fondesh.

SHTOJCA 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objekti i projektit është përcaktimi i një metode të integruar për menaxhimin e zonës bregdetare nëpërmjet kryerjes së reformave në politika, zhvillimit institucional, investimeve për mbrojtjen e burimeve bregdetare dhe nxitjes së një zhvillimi dhe menaxhimi të qëndrueshëm të bregdetit jugor të Huamarrësit.

Projekti përbëhet nga këto pjesë, që mund t'u nënshtrohen ndryshimeve të herëpashershme të bëra me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës për arritjen e këtyre objektivave:

Pjesa A: Krijimi i kapaciteteve të politikave dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare

1. Sigurimi i asistencës teknike për zhvillimin e një kuadri ligjor dhe politik dhe një kuadri stimujsh financiarë dhe ekonomikë për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare.

2. Sigurimi i pajisjeve, trajnimit dhe asistencës teknike për:

a) krijimin e kapaciteteve për planifikimin e përdorimit të tokës, zbatimin dhe respektimin e legjislacionit për përdorimin e tokës nga MRRTT, personeli bashkiak dhe policia ndërtimore;

b) krijimin e kapaciteteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura nga shembja e ndërtesave në bregdetin jugor;

c) krijimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e zonës bregdetare;

d) përpunimin e procedurave dhe praktikave për monitorimin dhe raportimin mjedisor me qëllimin për të plotësuar kriteret e Agjencisë Europiane të Mjedisit;

e) rinovimin dhe zbatimin e një plani menaxhimi për zonat e mbrojtura për Parkun Kombëtar të Butrintit;

f) përpunimin e planit për zhvillimin e bregdetit jugor.

Pjesa B: Ndërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës në bregdetin jugor

1. Të ndërtohen dy fusha plehrash rajonale për bashkinë e Sarandës dhe atë të Himarës dhe të pilotohet një skemë për mbledhjen e mbeturinave të ndërtimit dhe shembjeve, si edhe ndërgjegjësimin e komunitetit, nëpërmjet sigurimit të punimeve ndërtimore, shërbimeve inxhinierike, asistencës teknike dhe trajnimeve.

2. Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe sistemit të ujërave të zeza në qytetin e Sarandës, nëpërmjet sigurimit të shërbimeve inxhinierike, punimeve civile dhe pajisjeve.

3. Kthimi i portit të Sarandës në një terminal tragetesh dhe pasagjerësh, krijimi i kapaciteteve për

menaxhimin e terminalit dhe përfundimi i një vlerësimi të efekteve mbi mjedisin për zonën e terminalit nëpërmjet sigurimit të punimeve ndërtimore, shërbimeve inxhinierike dhe asistencës teknike.

4. Zbatimi i programit të ruajtjes dhe zhvillimit të fshatit bregdetar, nëpërmjet:

a) Sigurimit të granteve për nënprojektet për: i) përmirësimin e infrastrukturës, si riparimi apo zgjerimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, masave mbrojtëse për objektet e trashëgimisë kulturore, riparimit dhe rindërtimit të rrugëve rurale dhe infrastrukturave të tjera të fshatrave, dhe përmirësimit të infrastrukturës së turizmit; dhe ii) aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit dhe qëndrueshmërinë ekonomike, si aktivitetet pjesëmarrëse në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave dhe ngritja e fermave për demonstrim mjedisor.

b) Sigurimit të asistencës teknike dhe shërbimeve inxhinierike për krijimin e kapaciteteve dhe për aktivitetet teknike, si trajnimi i personelit të pushtetit vendor dhe personelit të përfituesve të tjerë në lidhje me përpunimin e planeve pjesëmarrëse për zhvillimin e fshatit.

Pjesa C: Dezinfectimi, rregullimi dhe rehabilitimi i uzinës kimike dhe fushës së mbeturinave të Porto Romanos

1. Sigurimi i asistencës teknike për menaxhimin e proceseve që kanë të bëjnë me mbetjet e rrezikshme dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit.

2. Sigurimi i asistencës teknike për përcaktimin e kriterëve për një program të monitorimit hidrogeologjik dhe mjedisor, nëpërmjet të cilit të maten nivelet e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore.

3. Sigurimi i asistencës teknike për përpilimin e një plani menaxhimi me bazë pjesëmarrjeje për përdorimin e tokës për zonën e Porto Romanos.

4. Sigurimi i punimeve civile për dezinfektimin, rregullimin dhe rehabilitimin e uzinës kimike dhe fushës së mbeturinave të Porto Romanos, përfshi dhe ndërtimin e një sistemi drenazhimi.

Pjesa D: Menaxhimi dhe monitorimi i projektit

Sigurimi i mallrave, asistencës teknike dhe trajnimit për:

1. krijimin dhe funksionimin e NJKP dhe mbështetjen e zbatimit të projektit nga NJKP;

2. krijimin dhe funksionimin e ekipeve të zbatimit të projektit brenda MF-së dhe administratës së Parkut Kombëtar të Butrintit;

3. monitorimin dhe vlerësimin e projektit dhe përpunimin e një strategjie të projektit për ndërgjegjësimin e publikut dhe komunikimin me të;

4. kryerjen e kontrolleve financiare;

5. përgatitja e fazës së dytë të programit.

Projekti parashikohet të përfundojë brenda datës 30 shtator 2009.

SHTOJCA 3 PROKURIMI

Seksioni I. Në përgjithësi

A. Të gjitha punimet dhe shërbimet (përveç shërbimeve të konsulencës) do të prokurohen në përputhje me dispozitat e seksionit I të dokumentit me titull “Udhëzime: Prokurimi në kuadrin e huave të BERZH-it dhe kredive të AZHN (IDA)” të datës maj 2004 (udhëzime për prokurimin) dhe me dispozitat e kësaj shtojce.

B. Të gjitha shërbimet e konsulencës do të prokurohen në përputhje me seksionet I dhe IV të dokumentit me titull “Udhëzime: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore” të datës maj 2004 (Udhëzime për konsulentët) dhe me dispozitat e kësaj shtojce.

C. Termat me shkronja të mëdha shtypi të përdorura më poshtë në këtë shtojcë për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi apo metodat e shqyrtimit nga Shoqata të kontratave të veçanta, kanë kuptimin e përcaktuar për to në udhëzimet për prokurimet ose në udhëzimet për konsulentët, sipas rastit.

Seksioni II. Metoda të Veçanta për Prokurimin e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve (përveç Shërbimeve të Konsulencës)

A. Tenderi Konkurrues Ndërkombëtar. Me përjashtim të rasteve të kundërta të parashikuara në pjesën B të këtij seksioni, kontratat do të jepen mbi bazën e Tenderave Konkurrues Ndërkombëtarë. Dispozitat e paragrafëve 2.55 dhe 2.56 të Udhëzimeve për Prokurimin, në të cilat parashikohet preferenca ndaj firmave vendase në vlerësimin e tenderave, aplikohen për mallrat e prodhuara në territorin e Huamarrësit.

B. Procedura të Tjera Prokurimi

1. Tenderi Konkurrues Kombëtar.

a) Në përgjithësi

Punimet për të cilat kostoja e parashikuar për çdo kontratë është më e vogël se shuma ekuivalente prej 500 000 USD, por më shumë se 100 000 USD do të prokurohen mbi bazën e kontratave të dhëna në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimeve.

b) Përmirësimi i Procedurave të Tenderit

Për të siguruar ekonomizim, efikasitet, transparencë dhe përputhje me dispozitat e seksionit 1 të udhëzimeve:

i) ftesat për pjesëmarrje në tender do të publikohen në rang lokal në gazetën rajonale dhe në të paktën dy gazeta kombëtare me qarkullim të madh, të paktën tridhjetë (30) ditë përpara përfundimit të afatit për dorëzimin e dokumenteve të tenderit nga pjesëmarrësit;

ii) pjesëmarrësit e huaj në tender nuk do të përjashtohen nga gara dhe pjesëmarrësve vendas nuk do t'u bëhet ndonjë trajtim me përparësi në procesin e tenderit. Ndërmarrjet shtetërore shqiptare do të lejohen të marrin pjesë në tender vetëm në rast se janë me vetëfinancim dhe funksionojnë në përputhje me legjislacionin tregtar të Huamarrësit;

iii) pjesëmarrja në tender nuk do të kufizohet vetëm te shoqëritë tregtare të regjistruara më parë;

iv) entet prokuruese do të përdorin dokumentacion tenderi, që aprovohet nga Shoqata përpara shpërndarjes te pjesëmarrësit në tender;

v) ofertat hapen publikisht, në një vend të caktuar dhe në prani të përfaqësuesve të pjesëmarrësve në tender, menjëherë pas skadimit të afatit të caktuar për paraqitjen e tyre;

vi) kur ofertat e paraqitura janë me çmime më të larta sesa parashikimi zyrtar, të gjitha ofertat mund të hidhen poshtë pasi të jetë marrë pëlqim paraprak nga Shoqata;

vii) kur numri i ofertave të paraqitura për tender është më i vogël se tre (3), të gjitha ofertat mund të hidhen poshtë dhe të kërkohet kryerja e një tenderi të ri pa qenë nevoja të merret pëlqim paraprak nga Shoqata;

viii) për paraqitjen e dokumentacionit të tenderit përdoret procedura e dorëzimit në një zarf të vetëm;

ix) shqyrtimi i kualifikimeve të pjesëmarrësve në tender bëhet vetëm për ofertën më të ulët të paraqitur; asnjë ofertë nuk do të hidhet poshtë në momentin e hapjes së ofertave për arsye të mungesës së kualifikimeve;

x) pjesëmarrësit në tender që bashkohen dhe lidhin kontratë si ndërmarrjeje e përbashkët konsiderohen me përgjegjësi solidare;

xi) pjesëmarrësve në tender mund t'u kërkohet të paraqesin garanci tenderi në shumën të përcaktuar mbi bazën e vlerës së parashikuar të kontratës dhe në një formë të pranueshme për Huamarrësin;

xii) për rastet kur të gjitha ofertat e paraqitura hidhen poshtë dhe kërkohet paraqitja e ofertave të reja merret pëlqim paraprak nga Shoqata;

xiii) kontratat i jepen pjesëmarrësit me ofertën më të ulët të vlerësuar që përmbush kushtet thelbësore, dhe që përcaktohet si i kualifikuar për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale në bazë të kritereve të vlerësimit të përcaktuara dhe të bëra të njohura që më parë;

xiv) negociatat mbas tenderit nuk lejohen as për pjesëmarrësin me ofertën më të ulët të vlerësuar dhe as për ndonjë pjesëmarrës tjetër;

xv) kontratat me kohëzgjatje të madhe (më shumë se tetëmbëdhjetë (18) muaj) duhet të përfshijnë dispozitat e nevojshme për rregullimin e çmimeve.

2. Eksplorimi i Tregut. Mallrat dhe punimet për të cilat kostoja e parashikuar për çdo kontratë është më e vogël se shumën ekuivalente prej 100 000 USD mund të prokurohen mbi bazën e kontratave të dhëna nëpërmjet Eksplorimit të Tregut.

3. Kontraktimi Direkt. Mallrat dhe punimet për të cilat Shoqata bie dakord që përmbushin kërkesat e Kontraktimit Direkt, mund të prokurohen në përputhje me dispozitat përkatëse që rregullojnë këtë metodë prokurimi.

4. Pjesëmarrja e Komunitetit. Mallrat, punimet dhe shërbimet e nevojshme për pjesën B.4(a) të projektit mund të prokurohen mbi bazën e pjesëmarrjes së komunitetit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Planin e Prokurimeve dhe në Manualin Operativ.

5. Praktikët Tregtare. Artikujt që do të financohen në kuadrin e granteve për nënprojektet e pjesës B.4(a)(ii) të projektit, zbatimi i të cilëve u ngarkohet shoqatave vendore apo ndërmarrjeve private, mund të prokurohen në përputhje me praktikët tregtare të pranueshme për Shoqatën, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Planin e Prokurimeve dhe në Manualin Operativ.

Seksioni III. Metoda të Veçanta për Prokurimin e Shërbimeve të Konsulentëve

A. Përzgjedhja me Bazë Cilësie dhe Kostoje. Me përjashtim të rasteve të kundërta të parashikuara në pjesën B të këtij seksioni, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen nëpërmjet kontratave të dhëna mbi bazën e Përzgjedhjes me Bazë Cilësie dhe Kostoje. Për qëllime të paragrafit 2.7 të Udhëzimeve për Konsulentët, lista e shkurtër e konsulentëve për ato shërbime për të cilat kostoja e parashikuar për çdo kontratë është më e vogël se shumën ekuivalente prej 100 000 USD mund të përfshijë vetëm konsulentë vendas.

B. Procedura të Tjera

1. Përzgjedhja mbi bazën e Buxhetit Fiks. Shërbimet e firmave konsulente për përgatitjen dhe zbatimin e fushatës së ndërgjegjësimit të publikut do të prokurohen nëpërmjet kontratave të dhëna mbi bazën e buxhetit fiks, në përputhje me dispozitat përkatëse të paragrafëve 3.1 dhe 3.5 të Udhëzimeve për Konsulentët.

2. Përzgjedhja mbi bazën e Kostos më të Ulët. Shërbimet e firmave konsulente për zbatimin e Projektit do të prokurohen nëpërmjet një kontrate të dhënë mbi bazën e Kostos më të Ulët, në përputhje me dispozitat përkatëse të paragrafëve 3.1 dhe 3.6 të Udhëzimeve për Konsulentët.

3. Përzgjedhja mbi bazën e Kualifikimeve të Konsulentëve. Shërbimet e firmave konsulente, për të cilat kostoja e parashikuar për çdo kontratë është më e vogël se shumën ekuivalente prej 200 000 USD, mund të

prokurohen nëpërmjet kontratave të dhëna në përputhje me dispozitat përkatëse të paragrafëve 3.1, 3.7 dhe 3.8 të Udhëzimeve për Konsulentët.

4. Përzgjedhja mbi bazën e Burimit të Vetëm Shërbimet që kryhen për rrethanat e parashikuara në paragrafin 3.10 të Udhëzimeve për Konsulentët për Përzgjedhjen mbi Bazën e Burimit të Vetëm, mund të prokurohen në përputhje me dispozitat përkatëse të paragrafëve nga 3.9 deri në 3.13 të Udhëzimeve për Konsulentët.

5. Konsulentët Individualë. Shërbimet për projekte që përmbushin kriteret e përcaktuara në fjalinë e parë të paragrafit 5.1 të Udhëzimeve për Konsulentët, mund të prokurohen nëpërmjet kontratave me konsulentë individualë në përputhje me dispozitat përkatëse të paragrafëve 5.2 dhe 5.3 të Udhëzimeve për Konsulentët. Në rastet e parashikuara në paragrafin 5.4 të udhëzimeve për konsulentët, këto kontrata mund t'u jepen konsulentëve individualë mbi bazën e burimit të vetëm.

Seksioni IV. Shqyrtimi nga Shoqata i Vendimeve të Prokurimit

Plani i Prokurimit përcakton se për cilat kontrata kërkohet shqyrtim paraprak nga Shoqata. Për të gjitha kontratat e tjera kërkohet Shqyrtim i Mëpasshëm nga Shoqata.

SHTOJCA 4 ZBATIMI I PROGRAMIT

Koordinimi dhe menaxhimi i Përgjithshëm i Projektit

1. Huamarrësi ka detyrim të zbatojë projektin në përputhje me mekanizmat e mëposhtëm të koordinimit të përgjithshëm:

a) Komisioni Drejtues i Projektit ngarkohet me mbikëqyrjen e Projektit.

b) MRRTT, nëpërmjet NJKP dhe ekipit të zbatimit të Projektit brenda Programit të Ruajtjes dhe Zhvillimit të Fshatit Bregdetar, ngarkohet me zbatimin e aktiviteteve të Projektit në përgjithësi dhe me sigurimin e mbështetjes për aktivitetet e zbatimit që do të kryhen nga institucione apo agjenci të tjera. Njësia e Koordinimit të projektit ngarkohet me koordinimin e Projektit, prokurimin, menaxhimin financiar, disbursimet dhe monitorimin dhe vlerësimin e Projektit.

c) Personi Autorizues i Projektit mbikëqyr punën e NJKP dhe është i autorizuar të aprovojë aktivitetet e prokurimit.

2. Huamarrësi ka detyrim të marrë të gjitha masat e nevojshme apo të sigurojë marrjen e këtyre masave, për zbatimin e KMMMS dhe të Planit të Shpërnguljes.

3. Huamarrësi ka detyrim të marrë të gjitha masat e nevojshme apo të sigurojë marrjen e këtyre masave, për të bërë të mundur zbatimin e Projektit brenda afateve të caktuara, në përputhje me Planin e Zbatimit të Projektit dhe Manualin Operativ.

4. Huamarrësi ka detyrim që brenda datës 3 tetor 2005 të emërojë anëtarët e Komisionit Drejtues të Projektit.

5. Huamarrësi ka detyrim që brenda datës 3 tetor 2005 NJKP të jetë në funksionim dhe me personelin e përshtatshëm, dhe që nga kjo datë të funksionojë në përputhje me termat e references të pranueshme për Shoqatën.

6. Huamarrësi ka detyrim që brenda datës 3 tetor 2005 personeli i ngarkuar me zbatimin e projektit brenda Programit të Ruajtjes dhe Zhvillimit të Fshatit Bregdetar dhe Ministrisë së Mjedisit të jetë emëruar, të ketë marrë detyrat dhe që nga kjo datë të funksionojë në përputhje me termat e referencës të pranueshme për Shoqatën.

7. Huamarrësi ka detyrim që:

a) të zbatojë politika dhe procedura të përshtatshme nëpërmjet të cilave të bëhet i mundur monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të Projektit dhe arritjes së objektivave të tij, në përputhje me tregues të pranueshme për Shoqatën;

b) mbi bazën e termave të referencës të pranueshme për Shoqatën, të përpilojë dhe t'i paraqesë Shoqatës rreth datës 31 tetor 2007 një raport ku të integrohen rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit të kryera në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni dhe përparimet e bëra në zbatimin e Projektit gjatë periudhës kohore deri në momentin e përpilimit të raportit, dhe ku të përcaktohen masat e propozuara për zbatimin me efikasitet të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij për periudhën kohore mbas datës së raportit;

c) të marrë në shqyrtim, së bashku me Shoqatën, brenda datës 30 nëntor 2007, apo brenda një date të mëvonshme të përcaktuar nga Shoqata, raportin e përmendur nga paragrafin (b) të këtij seksioni dhe që nga ai moment të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin me efikasitet të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij mbi bazën e konkluzioneve dhe propozimeve të raportit të sipërpërmendur dhe mendimeve të Shoqatës në lidhje me këtë çështje;

d) të përgatisë dhe t'i paraqesë Shoqatës për shqyrtim buxhetin e MRRTT për çdo vit kalendarik.

Koordinimi dhe Menaxhimi i Pjesës A të Projektit

8. MF ngarkohet me zbatimin e aktiviteteve të Pjesës A.2(c) dhe A.2(d) të Projektit.
9. MRKS, përmes Administratës së Parkut Kombëtar të Butrintit, dhe komunat e bashkitë bregdetare ngarkohen me zbatimin e Pjesës A.2(e) të Projektit.
Koordinimi dhe Menaxhimi i Pjesës B të Projektit
10. Bashkia e Sarandës dhe ajo e Himarës, në bashkëpunim me MRRTT, ngarkohen me zbatimin e aktiviteteve të Pjesës B.1 të Projektit.
11. MRRTT ngarkohet me zbatimin e aktiviteteve të pjesës B.3 të projektit.
12. MRKS, përmes Administratës së Parkut Kombëtar të Butrintit, dhe komunat e bashkitë bregdetare ngarkohen me zbatimin e disa aktiviteteve të veçanta të Pjesës B.4(a) të projektit.
Koordinimi dhe Menaxhimi i Pjesës C të Projektit
13. ME ngarkohet me zbatimin e aktiviteteve të Pjesës C të Projektit.
Koordinimi dhe Menaxhimi i Pjesës D të Projektit
14. ME dhe MKRS, përmes administratës së Parkut Kombëtar të Butrintit, në bashkërendim me MRRTT, ngarkohen me zbatimin e aktiviteteve të Pjesës D të Projektit.

L I G J
Nr.9424, datë 6.10.2005

PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli i vlerësimit strategjik mjedisor”, hartuar në kuadër të Konventës “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4673, datë 20.10.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu

PROTOKOLLI I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I KONVENTËS SË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR NË KONTEKSTIN NDËRKUFITAR

Palët e këtij protokolli,
duke njohur rëndësinë e integritetit të problemeve mjedisore dhe të atyre shëndetësore në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe aty ku është e mundur në politika dhe legjislacion;

duke u angazhuar në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe si rezultat duke u bazuar në konkluzionet e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio-de-Zhaneiro, Brazil, 1992), në veçanti në parimet 4 dhe 10 të Deklaratës së Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin dhe Axhendës 21, në rezultatet e Konferencës së Tretë Ministrore mbi Mjedisin dhe Shëndetësinë (Londër, 1999) dhe të Samitit Botëror mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm (Johanesburg, Afrika e Jugut, 2002);

duke pasur parasysh Konventën mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në Kontekst Ndërkufitar, nënshkruar në Espo, Finlandë më 25 shkurt 1991 dhe vendimin II/9 të palëve të saj të marrë në Sofje më 27 shkurt 2001, sipas të cilit është vendosur të përgatitet një protokoll ligjërsh i detyrueshëm mbi vlerësimin strategjik mjedisor;

duke pranuar se vlerësimi strategjik mjedisor duhet të ketë një rol të rëndësishëm në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe, aty ku është e mundur, në politikat dhe legjislacion, dhe se zbatimi më i

gjerë i parimeve të vlerësimit strategjik mjedisor në planet, programet, politikat dhe legjislacion do të forcojë më tej analizën sistematike të pasojave të tyre domethënëse mjedisore;

duke marrë në konsideratë Konventën për akses në informacion, për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe akses në drejtësi për çështjet mjedisore, nënshkruar në Aarhus më 25 qershor 1998 dhe duke njohur paragrafët përkatës të Deklaratës së Lukas, miratuar në takimin e parë të palëve;

të ndërgjegjshme për dhënien rëndësi të pjesëmarrjes së publikut në vlerësimin strategjik mjedisor;

duke njohur përfitimet që do të vijnë në shëndetin dhe mirëqenien e brezave të sotëm dhe atyre të ardhshëm, nëse nevoja për të mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin e popullsisë merret parasysh në vlerësimin strategjik mjedisor, dhe duke mirënjohur punën e drejtuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për këtë çështje;

duke pasur parasysh nevojën dhe rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar në vlerësimin e efekteve ndërkufitare mjedisore, përfshirë edhe shëndetësore, të planeve, programeve dhe, aty ku gjen shtrirje, të politikave dhe legjislacionit të propozuar;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij protokollit është të krijojë kushtet për një nivel më të lartë mbrojtjeje të mjedisit, përfshirë edhe shëndetin:

- a) duke siguruar që çështjet mjedisore, përfshirë edhe ato shëndetësore, të merren thellësisht në konsideratë në zhvillimin e planeve dhe programeve;
- b) duke kontribuar në marrjen në konsideratë të çështjeve mjedisore dhe shëndetësore në përgatitjen e politikave dhe legjislacionit;
- c) duke vendosur procedura të qarta, transparente dhe efektive për vlerësimin strategjik mjedisor;
- d) duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në vlerësimin strategjik mjedisor; dhe
- e) duke integruar me këto mjete çështjet mjedisore dhe shëndetësore në masat dhe instrumentet e përcaktuara për zhvillim të qëndrueshëm.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e këtij protokollit:

1. “Konventë” i referohet Konventës mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar;
2. “Palë” i referohet një pale kontraktuese të këtij protokollit, me përjashtim të rastit kur në tekst ka tjetër indikacion;
3. “Pala e origjinës” i referohet palës ose palëve të këtij protokollit brenda juridiksionit të të cilave parashikohet përgatitja e planit ose programit;
4. “Pala e prekur” i referohet palës ose palëve të këtij protokollit, të cilat mund të preken nga efekte mjedisore ose shëndetësore të planeve ose programeve;
5. “Plane dhe programe” i referohet planeve dhe programeve ose çdo ndryshimi në to, që:
 - a) janë kërkuar nga dispozita ligjore, rregullatore ose administrative;
 - b) janë subjekt i përgatitjes dhe/ose aprovimit nga një autoritet, ose përgatitjes nga një autoritet për aprovim nga parlamenti ose qeveria, nëpërmjet një procedure formale;
6. “Vlerësim strategjik mjedisor” i referohet vlerësimit të efekteve të mundshme, mjedisore dhe shëndetësore, të cilat përfshijnë përcaktimin e qëllimit të një raporti mjedisor, përgatitjen e tij, kryerjen e pjesëmarrjes së publikut dhe konsultimeve, marrjen në konsideratë të raporteve mjedisore, të rezultateve të pjesëmarrjes së publikut dhe konsultimeve në një plan ose program;
7. “Efekt mjedisor dhe shëndetësor” i referohet çdo efekti të mjedisit, përfshirë shëndetin e njeriut, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, sitët natyrore, asetet materiale, trashëgiminë kulturore dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;
8. “Publiku” i referohet një ose më shumë personave fizikë ose juridikë dhe, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën vendase, shoqatat, organizatat ose grupet e tyre.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

1. Secila palë do të ndërmarrë masat e domosdoshme legjislative, rregullatore dhe masa të tjera të nevojshme për të zbatuar dispozitat e këtij protokollit përmes një kuadri të qartë dhe transparent.
2. Secila palë do të përpiqet që zyrtarët dhe autoritetet të ndihmojnë dhe udhëzojnë publikun për

çështjet e mbuluara nga ky protokoll.

3. Secila palë do të sigurojë njohjen dhe mbështetjen e këtij protokoll nga shoqata, organizata ose grupe të cilat nxisin mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit në kuadrin e këtij protokoll.

4. Dispozitat e këtij protokoll nuk do të prekin të drejtën e një pale për të mbajtur ose ndërmarrë masa shtesë për çështjet e mbuluara nga ky protokoll.

5. Secila palë do të bëjë të ditur qëllimet e këtij protokoll në proceset përkatëse vendimmarrëse ndërkombëtare dhe në kuadrin e organizatave përkatëse ndërkombëtare.

6. Secila palë do të sigurojë që personat që ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me dispozitat e këtij protokoll nuk do të ndëshkohen, përndiqen ose shtypen në asnjë mënyrë për përfshirjen e tyre. Kjo dispozitë nuk do të prekë pushtetin e gjykatave vendase për të dhënë gjopa të arsyeshme në proceset gjyqësore.

7. Brenda qëllimit të dispozitave përkatëse të këtij protokoll, publiku duhet të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtat e tij pa u diskriminuar për arsye nënshtrësie, kombësie ose vendbanimi, dhe në rastin e një personi juridik, pa u diskriminuar për arsye të vendit ku është regjistruar ose të qendrës efektive të aktiviteteve të tij.

Neni 4

Fusha e aplikimit për planet dhe programet

1. Secila palë do të sigurojë që vlerësimi strategjik mjedisor do të kryhet për planet dhe programet sipas paragrafëve 2, 3 dhe 4, të cilat mund të kenë pasoja të ndjeshme në mjedis dhe shëndet.

2. Vlerësimi strategjik mjedisor duhet të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësinë, pyjet, peshkimin, energjinë, industrinë, përfshirë minierat, transportin, zhvillimin rajonal, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionin, turizmin, planet e përdorimit të tokës për qytetin dhe fshatin, të cilat vendosin kuadrin për miratimin e ardhshëm të zhvillimit të projekteve të listuara në aneksin I dhe të çdo projekti të listuar në aneksin II, të cilat kërkojnë një vlerësim strategjik mjedisor nën legjislacionin vendas.

3. Për planet dhe programet e tjera nga ato të paragrafit 2, të cilat vendosin kuadrin për miratimin e ardhshëm të projekteve, vlerësimi strategjik mjedisor do të kryhet aty ku e përcakton një palë, sipas nenit 5 paragrafi 1.

4. Për planet dhe programet e përmendura në paragrafin 2, të cilat përcaktojnë përdorimin e zonave të vogla në nivel lokal dhe për ndryshime të vogla në planet dhe programet e përmendura në paragrafin 2, vlerësimi strategjik mjedisor do të kryhet vetëm ku e përcakton një palë, sipas nenit 5 paragrafi 1.

5. Planet dhe programet e mëposhtme nuk janë subjekt i këtij protokoll:

a) Planet dhe programet, qëllimi i të cilave është t'i shërbejnë mbrojtjes së vendit ose emergjencave civile;

b) Plane dhe programe financiare ose buxhetore.

Neni 5

Shqyrtimi

1. Secila palë do të përcaktojë rastet kur planet dhe programet, e përmendura në nenin 4 paragrafët 3 dhe 4, mund të kenë pasoja domethënëse në mjedis dhe shëndet ose nëpërmjet një ekzaminimi rast pas rasti, ose me specifikim të tipeve të planeve dhe programeve, ose duke kombinuar të dyja përjasjet. Për këtë qëllim, në të gjitha rastet, secila palë do të marrë në konsideratë kriteret e vendosura në aneksin III.

2. Secila palë do të sigurojë që autoritetet mjedisore dhe shëndetësore, siç përmenden në nenin 9 paragrafi 1, do të konsultohen për aplikimin e procedurave të paragrafit 1 si më sipër.

3. Aty ku është e mundur, secila palë do të përpiqet të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së publikut të interesuar në ekzaminimin e planeve dhe programeve të këtij neni.

4. Secila palë do të sigurojë që konkluzionet pas procedurave të paragrafit 1, përfshirë edhe arsyet përse nuk kërkohet vlerësim strategjik mjedisor, do të bëhen të ditura në kohë me anë të njoftimeve publike ose dhe me mjete të tjera të përshtatshme, si mediat elektronike.

Neni 6

Shtrirja

1. Secila palë do të krijojë kushtet për përcaktimin e informacionit të rëndësishëm që do të përfshihet në raportin mjedisor në përputhje me nenin 7 paragrafi 2.

2. Secila palë do të sigurojë që autoritetet mjedisore dhe shëndetësore, të përmendura në nenin 9 paragrafi 1, të konsultohen gjatë përcaktimit të informacionit të rëndësishëm që do të përfshihet në raportin mjedisor.

3. Aty ku është e mundur, secila palë do të përpiqet të krijojë mundësitë për pjesëmarrjen e publikut të interesuar në përcaktimin e informacionit që do të përfshihet në raportin mjedisor.

Neni 7

Raporti mjedisor

1. Për planet dhe programet që i nënshtrohen vlerësimit strategjik mjedisor, secila palë do të sigurojë që të përgatitet raporti mjedisor.

2. Raporti mjedisor duhet të identifikojë, përshkruajë dhe vlerësojë pasojat e rëndësishme mjedisore dhe shëndetësore që mund të kenë planet ose programet në zbatim dhe alternativat e tij të arsyeshme, në përputhje me përcaktimet nën nenin 6. Raporti duhet të përmbajë këtë informacion të specifikuar në aneksin IV siç mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme, duke marrë në konsideratë:

- a) njohuritë dhe metodat aktuale të vlerësimit;
- b) përmbajtjet dhe nivelin e detajeve të planit ose programit dhe shkallën e tij në procesin e vendimmarrjes;
- c) interesat e publikut;
- d) nevojat për informacion nga organi vendimmarrës.

3. Secila palë do të sigurojë që raportet mjedisore të jenë me cilësinë e mjaftueshme për t'u pranuar nga kërkesat e këtij protokolli.

Neni 8

Pjesëmarrja e publikut

1. Secila palë do të sigurojë mundësi të shpejta, të shpeshta dhe efektive për pjesëmarrjen e publikut në vlerësimin strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, atëherë kur të gjitha mundësitë janë të hapura.

2. Secila palë do të sigurojë që projektet e planeve ose programeve dhe raporti mjedisor të jenë të disponueshme për publikun në kohën e duhur, duke përdorur mediat elektronike ose mjete të tjera të përshtatshme.

3. Secila palë do të sigurojë që të identifikohet publiku i interesuar për qëllimet e paragrafit 1 dhe 4, përfshirë këtu organizatat jofitimprurëse të fushës.

4. Secila palë do të sigurojë që publiku, të cilit i referohet paragrafi 3, të ketë mundësinë për të shprehur opinionin mbi projektin e planit ose të programit dhe mbi raportin mjedisor brenda një harku kohor të arsyeshëm.

5. Secila palë do të sigurojë që masat e detajuara për informimin e publikut dhe konsultimin e publikut të interesuar janë përcaktuar dhe shpallur publikisht. Për këtë qëllim, secila palë do të marrë në konsideratë brenda kufijve të mundshëm elementet e listuara në aneksin V.

Neni 9

Konsultimi me autoritetet mjedisore dhe shëndetësore

1. Secila palë do të përcaktojë autoritetet që do të konsultohen, të cilat mund të preken nga pasojat mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit ose programit, për arsye të përgjegjësisë të tyre specifike mjedisore ose shëndetësore.

2. Projekti i planit ose programit dhe raporti mjedisor do të jetë i disponueshëm për autoritetet e përmendura në paragrafin 1.

3. Secila palë do të sigurojë që autoriteteve të përmendura në paragrafin 1 t'u jepet mundësia të shprehin mendimin e tyre mbi projektin e planit ose programit dhe mbi raportin mjedisor, në mënyrë të shpejtë, efektive dhe në kohë.

4. Secila palë do të përcaktojë masat e detajuara për të informuar dhe konsultuar autoritetet mjedisore dhe shëndetësore të përmendura në paragrafin 1.

Neni 10

Konsultimet ndërkufitare

1. Kur pala e origjinës konsideron se zbatimi i një plani ose programi mund të ketë pasoja të rëndësishme ndërkufitare, mjedisore ose shëndetësore, ose kur pala që mund të preket ndjeshëm e kërkon, pala e origjinës duhet të njoftojë palën e prekur sa më shpejt që të jetë e mundur, para zbatimit të planit ose programit.

2. Ky njoftim duhet të përmbajë ndërmjet të tjerash:

a) projektin e planit ose programit dhe raportin mjedisor, ku të përfshihet informacion mbi pasojat e tij ndërkufitare, mjedisore ose shëndetësore;

b) informacion mbi procedurën e vendimmarrjes, ku të përfshihet një afat i arsyeshëm kohor për transmetimin e komenteve.

3. Pala e prekur do t'i tregojë palës së origjinës, brenda kohës së specifikuar në njoftim, se kur dëshiron të bëjë konsultime përpara zbatimit të planit ose programit dhe, nëse ndodh kështu, palët e interesuara do të hyjnë në konsultime për pasojat e mundshme ndërkufitare, mjedisore ose shëndetësore, të zbatimit të planit ose programit dhe masat e menduara për të parandaluar, zvogëluar ose zbutur pasojat negative.

4. Kur ndodhin këto konsultime, palët e interesuara do të bien dakord për masat e detajuara për t'u siguruar që publiku i interesuar dhe autoritetet, e përmendura në nenin 9 paragrafi 1 të palës së prekur, të jenë të informuar dhe t'u jetë dhënë mundësia e shprehjes së mendimit të tyre mbi projektin e planit ose programit dhe mbi raportin mjedisor brenda një harku të arsyeshëm kohor.

Neni 11

Vendimi

1. Secila palë do të sigurojë që, gjatë zbatimit të një plani ose programi, të merren seriozisht në konsideratë:

a) konkluzionet e raportit mjedisor;

b) masat për të parandaluar, zvogëluar ose zbutur pasojat negative të identifikuara në raportin mjedisor dhe

c) komentet e dhëna në përputhje me nenet 8, 9 dhe 10.

2. Secila palë do të sigurojë që, kur miratohet një plan ose program, publiku, autoritetet e përmendura në nenin 9 paragrafi 1 dhe palët e konsultuara sipas nenit 10, të jenë të informuara dhe që u vënë në dispozicion plani ose programi bashkë me një shpallje që përmbledh se si çështjet mjedisore dhe shëndetësore janë përfshirë në të, si janë marrë në konsideratë komentet e marra sipas neneve 8, 9 dhe 10 dhe arsyet për ta miratuar atë, bazuar në marrjen në konsideratë të alternativave të arsyeshme.

Neni 12

Monitorimi

1. Secila palë do të monitorojë pasojat e ndjeshme, mjedisore ose shëndetësore, të zbatimit të planit ose programit, të miratuara në nenin 11, në mënyrë që, ndërmjet të tjerash, të identifikojë në një fazë të hershme pasoja negative të paparashikuara dhe të jetë në gjendje të ndërmarrë masat e nevojshme rregulluese.

2. Rezultatet e monitorimit të kryer do të jenë disponibël, në përputhje me legjislacionin kombëtar, për autoritetet e përmendura në nenin 9 paragrafi 1 dhe për publikun.

Neni 13

Politikat dhe legjislacioni

1. Secila palë do të përpiqet të sigurojë që çështjet mjedisore dhe shëndetësore të merren në konsideratë dhe të integrohen në masën e duhur në përgatitjen e propozimeve të saj për politikat dhe legjislacionin që mund të ketë pasoja të ndjeshme në mjedis dhe në shëndet.

2. Në aplikimin e paragrafit 1, secila palë do të marrë parasysh parimet dhe elementet e duhura të këtij protokollit.

3. Secila palë do të përcaktojë, aty ku është e përshtatshme, masat praktike për marrjen në konsideratë dhe përfshirjen e çështjeve mjedisore dhe shëndetësore në përputhje me paragrafin 1, duke pasur parasysh nevojën për transparencë në vendimmarrje.

4. Secila palë do të raportojë në mbledhjen e palëve të Konventës, që do të jetë edhe mbledhje e palëve të këtij protokollit, për zbatimin e këtij neni.

Neni 14

Mbledhja e palëve të Konventës do të jetë edhe mbledhje e palëve të këtij protokollit

1. Mbledhja e palëve të Konventës do të shërbejë edhe si mbledhje e palëve të këtij protokollit. Mbledhja e parë e palëve të Konventës, që do të jetë edhe mbledhje e palëve të këtij protokollit, do të mbledhet jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij protokollit dhe në kombinim me mbledhjen e palëve të Konventës nëse një mbledhje e kësaj të fundit është planifikuar për atë periudhë. Mbledhjet e mëpasme të palëve të Konventës, që do të jenë edhe mbledhje të palëve të protokollit, do të kombinohen me mbledhjet e palëve të

Konventës, me përjashtim të rastit kur vendoset ndryshe nga mbledhja e palëve të Konventës, që do të jetë edhe mbledhje e palëve të këtij protokoll.

2. Palët e kësaj Konvente, që nuk janë palë të këtij protokoll, mund të marrin pjesë si vëzhgues në zhvillimin e çdo sesioni të mbledhjes së palëve të Konventës, që do të jetë edhe mbledhje e palëve të këtij protokoll. Kur mbledhja e palëve të Konventës shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij protokoll, vendimet nën këtë protokoll do të merren vetëm nga palët e këtij protokoll.

3. Kur mbledhja e palëve të Konventës është edhe mbledhje e palëve të protokollit, çdo anëtar i Byrosë së mbledhjes së palëve, që përfaqëson një palë në Konventë, që në këtë moment nuk është palë e këtij protokoll, do të zëvendësohet me një anëtar tjetër që do të zgjidhet nga dhe ndërmjet palëve të këtij protokoll.

4. Mbledhja e palëve e Konventës, që do të jetë edhe mbledhje e palëve të këtij protokoll, do të rishikojë rregullisht zbatimin e këtij protokoll dhe, për këtë qëllim:

a) do të rishikojë politikën dhe përfaqëson metodologjike për vlerësimin strategjik mjedisor, me qëllim përmirësimin e procedurave të përshkruara në këtë protokoll;

b) do të shkëmbejë informacion rreth përvojës së fituar në vlerësimin strategjik mjedisor dhe në zbatimin e këtij protokoll;

c) do të kërkojë, aty ku shihet e përshtatshme, shërbimet dhe bashkëpunimin e organizmave kompetentë që kanë përvojën e duhur për realizimin e qëllimeve të këtij protokoll;

d) do të krijojë organizma të tillë subsidiare, si ta gjykojë të nevojshme, për zbatimin e protokollit;

e) do të marrë në konsideratë dhe të provojë propozime për amendimin e këtij protokoll kur është e domosdoshme; dhe

f) do të marrë në konsideratë dhe të ndërmarrë çdo veprim tjetër, përfshirë veprime për t'u ndërmarrë së bashku nën këtë protokoll dhe nën Konventë, të cilat mund të nevojiten për realizimin e qëllimeve të këtij protokoll.

5. Rregullat e procedurave të mbledhjes së palëve të Konventës do të aplikohen *mutatis mutandis* për këtë protokoll, me përjashtim të rastit kur vendoset ndryshe me konsensus nga mbledhja e palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij protokoll.

6. Në takimin e saj të parë, mbledhja e palëve të Konventës, që shërben si mbledhje e palëve të këtij protokoll, do të marrë në konsideratë dhe do të miratojë modalitetet për të aplikuar procedurat për rishikimin e përputhshmërisë me Konventën të këtij protokoll.

7. Secila palë do të raportojë në mbledhjen e palëve të Konventës, që do të jetë edhe mbledhje e palëve të këtij protokoll, për masat që ka marrë për zbatimin e protokollit, në intervale kohe të përcaktuara nga mbledhja e palëve të Konventës, që shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij protokoll.

Neni 15

Marrëdhëniet me marrëveshje të tjera ndërkombëtare

Dispozitat e këtij protokoll do të zbatohen pa paragjykim ndaj Konventës për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar dhe Konventës për akses ndaj informacionit, pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe akses në drejtësi për çështjet mjedisore të UNECE-s (Komisioni Ekonomik për Europën i Kombeve të Bashkuara).

Neni 16

E drejta e votës

Përveç rastit të përmendur në paragrafin e mëposhtëm, secila palë e këtij protokoll do të ketë një votë.

1. Organizatat e integritetit ekonomik rajonal do të ushtrojnë të drejtën e votës për çështjet brenda kompetencës së tyre, me një numër votash të barabarta me numrin e shteteve të tyre anëtare, të cilat janë palë e këtij protokoll. Këto organizata nuk do të ushtrojnë të drejtën e votës nëse shtetet e tyre anëtare ushtrojnë të vetën dhe anasjelltas.

Neni 17

Sekretariati

Sekretariati i krijuar sipas nenit 13 të Konventës do të shërbejë si sekretariat i këtij protokoll dhe neni 13 paragrafët (a) deri (c) të Konventës mbi funksionet e sekretariatit do të zbatohet *mutatis mutandis* për këtë protokoll.

Neni 18

Anekset

Anekset e këtij protokollit janë pjesë integrale e tij.

Neni 19

Amendimet e protokollit

1. Çdo palë mund të propozojë amendime të protokollit.
2. Subjekti i paragrafit 3, procedurat e propozimit, miratimit dhe hyrjes në fuqi të një amendimi të Konventës, të përcaktuara në paragrafët 2 deri 5 të nenit 14 të Konventës, do të zbatohen *mutatis mutandis* për amendimet e këtij protokollit.
3. Për qëllimet e këtij protokollit, tre të katërtat e domosdoshme të palëve, që e kanë ratifikuar, miratuar ose pranuar atë, për hyrjen në fuqi të një amendimi, do të llogariten në bazë të numrit të palëve në momentin e miratimit të amendimit.

Neni 20

Zgjidhja e konflikteve

Dispozitat mbi zgjidhjen e konflikteve të nenit 15 të Konventës do të aplikohen *mutatis mutandis* për këtë protokoll.

Neni 21

Nënshkrimi

Ky protokoll do të hapet për nënshkrim në Kiev (Ukrainë) nga 21 deri më 23 maj 2003 dhe më pas në zyrat qendore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri më 31 dhjetor 2003. Protokollit mund të nënshkruhet nga shtetet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, si dhe shtetet me status konsultativ pranë Komisionit Ekonomik për Europën sipas paragrafëve 8 dhe 11 të Rezolutës së Këshillit Ekonomik dhe Social 36 (IV) të 28 marsit 1947, dhe nga organizatat e integritit ekonomik të përbëra nga shtete sovraane, anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, te të cilat shtetet anëtare kanë transferuar kompetenca mbi çështjet që mbulon ky protokoll, përfshirë edhe kompetencën për të nënshkruar traktate për këto çështje.

Neni 22

Depozituesi

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të kryejë funksionin e depozituesit të këtij protokollit.

Neni 23

Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky protokoll do të jetë subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga shtetet nënshkruese dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik të përmendura në nenin 21.
2. Ky protokoll do të hapet për aderim nga 1 janari 2004 për shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik të përmendura në nenin 21.
3. Çdo shtet tjetër, i cili nuk është përmendur në paragrafin 2 të mësipërm, që është anëtar i Kombeve të Bashkuara, mund të aderojë në protokoll pas miratimit të mbledhjes së palëve të Konventës, që do të jetë edhe mbledhje e palëve të këtij protokollit.
4. Çdo organizatë rajonale e integritit ekonomik e përmendur në nenin 21, e cila bëhet palë e këtij protokollit pa asnjë nga shtetet e saj anëtare, përjashtohet nga të gjitha detyrimet e këtij protokollit. Nëse një ose më shumë shtete që janë palë të këtij protokollit janë edhe anëtare të organizatave të tilla, organizata dhe shtetet e saj anëtare do të vendosin për përgjegjësitë përkatëse për përmbushjen e detyrimeve nën këtë protokoll. Në këto raste, organizata dhe shtetet e saj anëtare nuk do të ushtrojnë të drejtat e tyre nën këtë protokoll në të njëjtën kohë.
5. Në instrumentin e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, organizatat rajonale të integritit ekonomik të përmendura në nenin 21 do të deklarojnë shtrirjen e kompetencave të tyre mbi çështjet e rregulluara nga ky protokoll. Këto organizata do të informojnë gjithashtu depozituesin për çdo ndryshim të rëndësishëm për shtrirjen e kompetencave të tyre.

Neni 24
Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

2. Për qëllimet e paragrafit 1 më sipër, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik, i përmendur në nenin 21, nuk do të llogaritet si instrument shtesë i atyre të depozituar nga shtetet anëtare të këtyre organizatave.

3. Për çdo shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik, të përmendur në nenin 21, i cili ratifikon, pranon ose miraton këtë protokoll ose aderon në të pas depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, protokollin do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit nga ky shtet ose organizatë të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

4. Ky protokoll do të zbatohet për plane, programe, politika dhe legjislacion për të cilin akti i parë formal përgatitor është pasardhës i datës në të cilën ky protokoll hyn në fuqi. Kur pala, nën juridiksionin e së cilës është projektuar përgatitja e një plani, programi, politike apo legjislacioni, është njëra për të cilën zbatohet paragrafi 3, ky protokoll do të zbatohet për plane, programe, politika dhe legjislacion për të cilat akti i parë formal përgatitor është pasardhës ndaj datës në të cilën protokollin hyn në fuqi për atë palë.

Neni 25
Tërheqja

Në çdo moment, katër vjet pas datës në të cilën ky protokoll ka hyrë në fuqi për një palë, kjo palë mund të tërhiqet nga protokollin duke njoftuar me shkrim depozituesin. Çdo tërheqje e tillë do të ketë efekt ditën e nëntëdhjetë pas datës së marrjes së tij nga depozituesi. Asnjë tërheqje e tillë nuk do të prekë zbatimin e neneve 5 deri 9, 11 dhe 13 për vlerësimin strategjik mjedisor nën këtë protokoll, i cili ishte tashmë i filluar ose zbatimin e nenit 10 për njoftimin ose kërkesën i cili ishte bërë para se kjo tërheqje të ketë efekt.

Neni 26
Teksti autentik

Originali i këtij protokollin, tekstin anglisht, frëngjisht dhe rusisht i të cilit është njësoj autentik, do të depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Të nënshkruarit, në prani të dëshmitarëve të pranishëm, duke qenë plotësisht të autorizuar për këtë, kanë firmosur këtë protokoll.

Bërë në Kiev (Ukrainë), sot më njëzet e një maj, dy mijë e tre.

ANEKSI I

LISTA E PROJEKTEVE REFERUAR NENIT 4 PARAGRAFI 2

1. Rafineritë e naftës (duke përjashtuar ndërmarrjet që prodhojnë lubrifikantë nga nafta bruto) dhe impiantet e lëngëzimit dhe të përpunimit të 500 metrik ton qymyr ose rërë bituminoze në ditë;

2. Termocentrale të prodhimit të energjisë dhe impiante të tjera të djegies me prodhim nxehtësie prej 300 MV ose më shumë, dhe stacionet bërthamore, dhe reaktorët e tjerë bërthamorë (duke përjashtuar impiantet kërkimore, fuqia maksimale e të cilave nuk kalon 1 kilovat ngarkesë termike të vazhdueshme);

3. Impiante për prodhimin ose pasurimin e lëndëve djegëse bërthamore, për ripërpunimin e lëndëve djegëse bërthamore të rrezatuara ose për ruajtje, depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve radioaktive;

4. Impiantet e mëdhaja për shkrirjen fillestare të gëzës dhe çelikut dhe për prodhimin e metaleve pa përmbajtje hekuri;

5. Impiantet për nxjerrjen e asbestit dhe për përpunimin dhe transformimin e asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest: për produktet e asbest-çimentos, me një prodhim vjetor prej më shumë se 20.000 metrik tonë të produktit përfundimtar; për fraksionimin e materialit, me një prodhim vjetor prej më shumë se 50 metrik tonë të produktit përfundimtar dhe për prodhimin e asbesteve të tjera prej më shumë se 200 metrik tonë në vit;

6. Impiantet e integruara kimike;

7. Ndërtimi i rrugëve automobilistike, rrugëve ekspres¹ dhe linjave të trafikut hekurudhor të distancave

¹ Për qëllime të këtij protokollin:

“Autostradë” do të thotë një rrugë e projektuar dhe e ndërtuar për trafik automobilistik, e cila nuk u shërben zonave përreth, dhe e cila:

a) lejohet vetëm në pika të veçanta ose, përkohësisht, me karrexhata të ndara për të dyja drejtimet e trafikut, të ndara nga njëra-tjetra nga një shirit ndarës jo i lejueshëm për trafikun ose, në raste të rralla, me mjete

- të gjata dhe të aeroporteve **, me gjatësi bazë kalueshmërie prej 2100 metra ose më shumë;
8. Tubacionet me diametër të madh për transportimin e naftës dhe gazit;
 9. Portet e tregtimit dhe gjithashtu rrugët ujore në brendësi të tokës, dhe portet për trafikun ujor në brendësi të tokës, që lejojnë kalimin e anijeve me tonazh mbi 1350 tonë;
 10. Impiante për djegie, trajtim kimik ose groposje të mbeturinave toksike dhe të rrezikshme;
 11. Depozitat e mëdha dhe rezervuarët;
 12. Aktivitete të nxjerrjes së ujërave nëntokësore në rastet kur volumi vjetor i ujit që do të nxirret është 10 000 milionë m³;
 13. Prodhimi i pulpës dhe i letrës, me kapacitet prodhues 200 tonë/ditë ose më shumë;
 14. Miniera të mëdha, nxjerrja dhe përpunimi i metaleve ose qymyrit;
 15. Prodhimi i hidrokarbureve në det;
 16. Depozita të mëdha për magazinimin për qëllime tregtimi apo ruajtjeje për naftën, produktet e naftës dhe produktet kimike;
 17. Shpyllëzimi i zonave të mëdha.

ANEKSI II

ÇDO PROJEKT TJETËR SIPAS NENIT 4 PARAGRAFI 2

1. Projekte për ristrukturimin e zonave rurale;
2. Projekte për përdorimin e tokave jobujqësore ose të zonave gjysmënatyrore për qëllime të bujqësisë intensive;
3. Projekte të menaxhimit të ujërave për nevoja bujqësore, duke përfshirë projektet e vaditjes dhe të drenazhimit të tokës;
4. Impiante intensive të rritjes së bagëtive (duke përfshirë pularitë);
5. Pyllëzimi dhe shpyllëzimi për qëllime të ndryshimit të destinacionit të përdorimit të tokës;
6. Fermat intensive të peshkimit;
7. Stacionet bërthamore dhe reaktorët e tjerë bërthamorë*, që përfshijnë dhe çmontimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të këtyre stacioneve ose reaktorëve (duke përfshirë impiantet kërkimore, fuqia maksimale e të cilave nuk i kalon 1 kilovat ngarkesë termike të vazhdueshme), ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;
8. Ndërtimi i linjave elektrike të tensionit të lartë me voltazh 220 kilovolt ose më shumë dhe një gjatësi 15 km ose më shumë, dhe projekte të tjera për transmetimin e energjisë elektrike nga kabllot kryesorë;
9. Impiantet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit dhe ujit të nxehtë;
10. Impiantet industriale për mbajtjen e gazit, avullit dhe ujit të nxehtë;
11. Ruajtja në sipërfaqe të lëndëve të djegshme dhe gazit natyror;
12. Ruajtja nën tokë e gazeve të djegshme;
13. Briketimi industrial i qymyrit dhe i linjtit;
14. Impiantet për prodhimin e energjisë hidroelektrike;
15. Impiante për përdorimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë;
16. Impiantet që nuk janë të përfshirë në aneksin I, të konceptuara:
 - për prodhimin dhe pasurimin e lëndëve djegëse bërthamore;
 - për përpunimin e lëndëve djegëse bërthamore të rrezatuara;
 - për depozitimin përfundimtar të lëndëve djegëse bërthamore të rrezatuara;
 - vetëm për depozitimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive;
 - vetëm për ruajtjen (planifikuar për më shumë se 10 vjet) të lëndëve djegëse bërthamore të rrezatuara në një vend të ndryshëm nga ai i prodhimit;
 - Për përpunimin dhe ruajtjen e mbetjeve radioaktive;
17. Guroret, minierat e hapura (karierat) dhe nxjerrja e torfës, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;
18. Minierat nëntokësore, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;
19. Nxjerrja e mineral-inerteve nga drenazhimi detar ose lumor;
20. Shpimet e thella, në veçanti (shpimet gjeotermike, shpimet për ruajtjen e mbetjeve bërthamore,

të tjera;

b) nuk do të jetë në të njëjtin nivel me asnjë rrugë, hekurudhë, shina tramvaji ose rrugë këmbësorësh; dhe

c) është e sinjalizuar vetëm si autostradë.

“Rrugë ekspres” do të thotë një rrugë e rezervuar për trafik makinash të lejuara vetëm nga lidhjet shumëkalimëshe ose nyjet e kontrolluara dhe në të cilën parkimi dhe ndalimi janë të ndaluara përgjatë korsive.

** Për qëllime të këtij protokoll, “Aeroport” do të thotë një aeroport që përputhet me përcaktimin e Konventës së Çikagos të vitit 1944 për krijimin e Organizatës së Aviacionit Civil (aneksi 14).

shpimet për furnizimet me ujë), duke përjashtuar shpimet për të kontrolluar qëndrueshmërinë e tokës;

21. Impiante industriale sipërfaqësore për nxjerrjen e qymyrit, naftës, gazit natyror, si dhe rërës bituminoze;

22. Vepra të integruara për shkrirjen fillestare të gizës dhe çelikut dhe për prodhimin e metaleve pa përmbytje hekurit, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

23. Impiante për prodhimin e gizës dhe çelikut (bashkimi primar ose sekondar) duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme;

24. Impiante për përpunimin e metaleve të hekurit (uzina të petëzimit, kovaçhana me çekiçë, aplikimi i veshjeve mbrojtëse me metal të përzier);

25. Fonderi të metaleve të hekurit;

26. Impiante për prodhimin e metaleve joferrike nga mineralet, koncentratet ose lëndët dytësore të proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

27. Impiante për përzierjen, duke përfshirë aliazhet e metaleve joferrike duke përjashtuar metalet me vlerë dhe duke përfshirë produktet e rikuperuara (rafinimi, derdhja në fonderi etj.), ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

28. Uzina për trajtimet sipërfaqësore të metaleve dhe materialeve plastike, duke përdorur një proces elektrolitik ose kimik;

29. Impiante për prodhimin dhe montimin e automjeteve dhe prodhimi i motorëve për automjete;

30. Molot;

31. Impiante për prodhimin dhe riparimin e avionëve;

32. Prodhimi i pajisjeve hekurudhore;

33. Hedhje në erë me eksploziv;

34. Impiante për pjekjen dhe sinterimin e mineraleve metalike;

35. Furrat e koksit (distilim i thatë i qymyrit);

36. Impiante për prodhimin e çimentos;

37. Impiante për prodhimin e qelqit dhe të fibrave të qelqit;

38. Impiante për shkrirjen e substancave minerale, duke përfshirë edhe fibrat minerale;

39. Prodhimi i produkteve qeramike me anë të djegies, në mënyrë të veçantë tjegullat e çative, tullave, tulla refraktare, tjegulla, veshje guri ose porcelani;

40. Impiante për prodhimin e kimikateve ose trajtimin e produkteve të ndërmjetme, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

41. Prodhimi i pesticideve dhe produkteve farmaceutike, bojërave dhe varakut, elastomereve dhe peroksive;

42. Impiante për magazinimin për qëllime tregtimi apo ruajtje për naftën, produktet e naftës dhe produktet kimike, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

43. Prodhimi i vajërave dhe yndyrnave shtazore dhe bimore;

44. Paketimi dhe ambalazhimi i produkteve bimore;

45. Prodhimi i produkteve bulmetore;

46. Fermentimi i birrës;

47. Prodhimi i shurupeve dhe ëmbëlsirave;

48. Impiante për therjen e kafshëve (thertore);

49. Impiante për përpunimin e amidonit industrial;

50. Fabrikat për peshkun dhe vajin e peshkut;

51. Fabrikat e sheqerit;

52. Impiante industriale për prodhimin e pulpës, letrës dhe fibrave të tjera të ngjashme, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

53. Impiantet për trajtimin paraprak ose ngjyrosjen e fibrave dhe tekstileve;

54. Impiante për trajtimin e lëkurëve dhe thundrave;

55. Impiante për përpunimin dhe prodhimin e celulozës;

56. Prodhimi dhe trajtimi i produkteve me bazë elastomeri;

57. Impiante për prodhimin e fibrave minerale artificiale;

58. Impiante për rikuperimin dhe shkatërrimin e lëndëve eksplozive;

59. Impiantet për prodhimin e asbestit dhe për përpunimin e produkteve të asbestit, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

60. Vendgrumbullimi dhe thertore për kafshë në fund të jetës;

61. Banka prove për motorë, turbina dhe reaktorë;

62. Rugë permanente që përdoren për kryerjen e garave dhe provave për mjete të motorizuara;

63. Tubacionet për transportimin e gazit ose naftës, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

64. Tubacionet për transportimin e kimikateve me diametër prej më shumë se 800 mm dhe gjatësi më

shumë se 40 km;

65. Ndërtimi i hekurudhave, faciliteteve intermodale dhe transportit dhe terminaleve intermodale, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

66.

67. Ndërtimi për tramvajet, ashensorët dhe hekurudhat e nëndheshme, të përdorura vetëm ose kryesisht për transport pasagjerësh;

68. Ndërtimi i rrugëve, duke përfshirë rregullimet dhe/ose zgjerimet e rrugëve ekzistuese, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

69. Ndërtimi i porteve dhe instalimeve portuale, duke përfshirë edhe portet e peshkimit, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

70. Ndërtimi i rrugëve ujore në brendësi të tokës dhe portet për trafikun ujor në brendësi të tokës, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

71. Portet e tregtimit, molot për ngarkim-shkarkim të lidhura me tokën ose porte të jashtme, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

72. Punimet për kanalizimet dhe drenazhimet;

73. Ndërtimi i aeroportëve dhe i fushave për avionë, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

74. Impiante për depozitimin e mbetjeve, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

75. Impiante për djegie ose trajtim kimik të mbeturinave të rrezikshme;

76. Magazini i skrapit të hekurit, duke përfshirë edhe skrapin e mjeteve lëvizëse;

77. Venddepozitimi të mbetjeve të trajtuara;

78. Nxjerrja e ujërave nëntokësore ose skemat artificiale të ringarkimit të ujërave nëntokësore, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

79. Punime për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve lumore;

80. Impiante të trajtimit të ujërave të zeza;

81. Dampat dhe rezervuarët e tjerë të projektuar për të mbajtur ujë ose për ta ruajtur atë për një kohë të gjatë, ato që nuk janë të përfshira në aneksin I;

82. Punimet në bregdet për të luftuar erozionin dhe punimet që do të ndryshojnë bregdetin gjatë ndërtimit, si p.sh. digat, molot dhe punime të tjera mbrojtëse detare, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe rikonstruktimin e punimeve të tilla;

83. Ujësjiellës të distancave të gjata;

84. Teleferikët e skive, ashensorët e skive dhe makina me kablo dhe zhvillimet e shoqëruara me këto lloj veprimtarish;

85. Marinat;

86. Fshatra turistike dhe komplekset e hoteleve jashtë zonave urbane dhe zhvillimet e shoqëruara me këto lloj veprimtarish;

87. Zonat e karvaneve dhe kampingjet;

88. Parqet zbavitëse;

89. Projekte të zhvillimeve industriale;

90. Projekte të zhvillimeve urbane, duke përfshirë edhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet e makinave;

91. Përfitim i tokave nga uji i detit

ANEKSI III

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E PASOJAVE TË MUNDSHME MJEDISORE DHE SHËNDETËSORE SERIOZE; PASOJAT I REFEROHEN NENIT 5 PARAGRAFI 1

1. Rëndësia e planit ose programit në integrimin e çështjeve mjedisore dhe shëndetësore, në veçanti, me synimin e nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm;

2. Shkalla në të cilën plani ose programi krijon një kuadër për projektet dhe aktivitetet e tjera qoftë për vendosjen, natyrën, përmasën dhe kushtet e punës, qoftë duke dhënë fonde;

3. Shkalla në të cilën plani ose programi influencon plane ose programe të tjera, përfshirë edhe ato të vendosura sipas një hierarkie;

4. Problemet mjedisore dhe shëndetësore të planit ose programit;

5. Natyra e pasojave mjedisore dhe shëndetësore, si mundësia që të ndodhin, kohëzgjatja, shpeshtësia, riparimi, magnituda dhe përhapja (si zona gjeografike ose numri i popullsisë që mund të preket);

6. Rreziqet në mjedis dhe shëndetësi;

7. Natyra ndërkufitare e pasojave;

8. Shkalla në të cilën plani ose programi do të prekë zona me vlerë ose delikate, përfshirë peizazhe me status mbrojtjeje kombëtar ose ndërkombëtar të njohur.

ANEKSI IV
INFORMACIONI SIPAS NENIT 7 PARAGRAFI 2

1. Përmbajtja dhe objektivat kryesorë të planit ose programit dhe lidhjet e tij me plane ose programe të tjera;
2. Aspektet e rëndësishme të gjendjes aktuale të mjedisit, përfshirë shëndetësinë dhe zhvillimet e mundshme në rastin kur plani ose programi nuk do të zbatoheshin;
3. Karakteristikat e mjedisit, përfshirë edhe shëndetësinë, në zonat që mund të preken në mënyrë domethënëse;
4. Problemet mjedisore edhe ato shëndetësore, të rëndësishme për planin ose programin;
5. Objektivat mjedisore dhe shëndetësore të vendosura në planin ndërkombëtar, kombëtar ose në nivele të tjera, të cilat janë të rëndësishme për planin ose programin, si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva dhe çështje të tjera mjedisore dhe shëndetësore janë marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së tyre;
6. Pasoja* domethënëse mjedisore dhe shëndetësore, siç janë përcaktuar në nenin 2 paragrafi 7;
7. Masat për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar çdo pasojë negative në mjedis dhe në shëndet, të cilat dalin si rrjedhojë e zbatimit të planit ose programit;
8. Një përshkrim i arsyeve për të zgjedhur alternativat e diskutuara së bashku me një përshkrim se si është bërë vlerësimi, përfshirë këtu edhe vështirësitë në dhënien e informacionit që do të përfshijnë mangësitë teknike dhe mungesën e njohurive;
9. Masat e parashikuara për të monitoruar pasojat mjedisore dhe shëndetësore të zbatimit të planit ose programit;
10. Pasoja e mundshme dhe të rëndësishme ndërkufitare mjedisore dhe shëndetësore;
11. Një përmbledhje joteknike e informacionit të dhënë.

* Për qëllim të këtij protokoll, stacionet bërthamore dhe reaktorët e tjerë bërthamorë pushojnë së qeni të tillë kur të gjitha lëndët djegëse bërthamore ose elemente të tjera të ndotura nga radioaktiviteti janë hequr përfundimisht nga stacioni.

** Për qëllime të këtij protokoll, me “aeroport” do të kuptojmë një aeroport që është konform përcaktimit të Konventës së Çikagos të vitit 1944 për krijimin e Organizatës së Aviacionit Civil (aneksi 14).

ANEKSI V
INFORMACIONI SIPAS NENIT 8 PARAGRAFI 5

1. Plani ose programi i propozuar dhe natyra e tij;
2. Autoriteti përgjegjës për miratimin e tij;
3. Procedurat e parashikuara, përfshirë edhe:
 - a) fillimin e procedurës;
 - b) mundësinë e pjesëmarrjes së publikut;
 - c) kohën dhe vendin e konsultimit të parashikuar me publikun;
 - d) autoritetin prej të cilit mund të merret informacioni i duhur dhe ku ky informacion është depozituar për shqyrtim nga publiku;
 - e) autoritetin tek i cili duhen depozituar komentet dhe pyetjet, si dhe kohën e përcaktuar për transmetimin e komenteve dhe pyetjeve;
 - f) çfarë informacioni mjedisor dhe shëndetësor lidhur me planin ose programin e propozuar është i disponueshëm;
- 4) Kur plani ose programi do të jetë subjekt i procedurës së vlerësimit ndërkufitar.

* Këto pasoja duhet të përfshijnë efektet anësore, mbivendosëse, sinergjike, afatshkurtra, afatmesme, afatgjata, të përhershme dhe të përkohshme, ato pozitive dhe negative.

L I G J
Nr.9425, datë 6.10.2005

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E VITIT 1979
“PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË MADHE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4674, datë 20.10.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

KONVENTA E VITIT 1979
MBI NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË MADHE

Palët në këtë Konventë,

të vendosura për të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin në fushën e ndotjes së mjedisit;

të ndërgjegjshme për rëndësinë e aktiviteteve të Komisionit Ekonomik për Europën të Kombeve të Bashkuara për forcimin e këtyre lidhjeve dhe këtij bashkëpunimi, veçanërisht në fushën e ndotjes së ajrit, përfshirë transportin në distancë të madhe të ndotësve të ajrit;

duke njohur kontributin e Komisionit Ekonomik për Europën për zbatimin e shumanshëm të dispozitave përkatëse të Aktit Final të Konferencës mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë;

duke marrë parasysh thirrjen e bërë në kapitullin e Aktit Final të Konferencës mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë, lidhur me mjedisin, për bashkëpunimin për të luftuar ndotjen e ajrit dhe efektet e kësaj ndotjeje, veçanërisht për transportimin e ndotësve të ajrit në distancë të madhe dhe për përmirësimin, nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, të një programi të gjerë të vrojtimit dhe vlerësimit të transmetimit në distancë të madhe të ndotësve të ajrit, duke filluar me dyoksidin e squfurit pastaj duke kaluar mundësisht të ndotësit të tjerë;

duke marrë parasysh dispozitat përkatëse të Deklaratës së Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe në veçanti nenin 21, i cili shpreh bindjen e përbashkët se, sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare, shtetet kanë të drejtën maksimale për të shfrytëzuar vetë burimet e tyre sipas politikave të tyre mjedisore dhe kanë për detyrë ta bëjnë këtë në mënyrë të tillë që aktivitetet e ushtruara brenda kufijve të juridiksionit të tyre dhe nën kontrollin e tyre të mos shkaktojnë dëme në mjedisin e shteteve të tjera ose në rajone që nuk janë nën juridiksionin ndërkombëtar;

duke njohur mundësinë që ndotja e ajrit, përfshirë ndotjen ndërkufitare të ajrit, shkakton efekte dëmtese afatshkurtra ose afatgjata;

duke pasur frikë se rritja e parashikuar e nivelit të shkarkimeve të ndotësve të ajrit në rajon mund të rrisë efektet e tyre dëmtese;

duke njohur nevojën e studimit të ndërlikimeve nga transporti i ndotësve të ajrit dhe kërkesat e zgjidhjeve për problemet e caktuara;

duke afirmuar vendimin e tyre për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar aktiv për të përpunuar politikat kombëtare të nevojshme nëpërmjet shkëmbimeve të informacioneve konsultative dhe aktiviteteve të kërkimit dhe të vrojtimit, si dhe për të koordinuar masat e marra nga vendet për të luftuar ndotjen e ajrit, përfshirë ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) Shprehja “ndotje e ajrit” nënkupton futjen në atmosferë direkt ose indirekt nga njeriu, të substancave ose të energjisë me veprim dëmtues ndaj natyrës, që vënë në rrezik shëndetin e njeriut, që dëmtojnë burimet biologjike dhe ekosistemet, që shkatërrojnë të mirat materiale dhe që çojnë në prekjën ose dëmtimin e vlerave të bukurisë dhe të dobive të tjera legjitime të mjedisit, dhe shprehja “ndotësit e ajrit” përdoret në të njëjtin kuptim.

b) Shprehja “ndotje ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe” nënkupton ndotjen e ajrit, burimi fizik i të cilit përfshihet totalisht ose pjesërisht në një zonë që i nënshtrohet juridiksionit kombëtar të një shteti dhe që ushtron efekte dëmtuese në një zonë që i nënshtrohet juridiksionit të një shteti tjetër në një distancë të tillë ku zakonisht nuk është e mundur të dallohet kontributi i burimeve individuale të shkarkimit ose të grupeve të burimeve.

Neni 2

Parimet themelore

Palët kontraktuese, duke marrë parasysh në formën e duhur faktet dhe problemet në shqyrtim, janë të vendosura të mbrojnë njeriun dhe mjedisin e tij nga ndotja e ajrit dhe do të përpiqen të kufizojnë dhe, sa të jetë e mundur, të pakësojnë gradualisht për të parandaluar ndotjen e ajrit, përfshirë ndotjen e ajrit në distancë të madhe.

Neni 3

Në kuadër të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpunojnë pa vonesë, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, konsultimeve dhe aktiviteteve kërkimore dhe vrojtimeve, politikat dhe strategjitë që do të shërbejnë për të luftuar derdhjen e ndotësve të ajrit, duke marrë parasysh tashmë përpjekjet e ndërmarra në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 4

Palët kontraktuese do të shkëmbejnë informacion dhe do të veprojnë me tërë fuqinë e njohurive të tyre mbi politikat e tyre, aktivitetet shkencore dhe masat teknike duke pasur objekt të luftojnë me tërë mundësitë flakjen e ndotësve të ajrit që mund të kenë efekte dëmtuese, si dhe të pakësojnë ndotjen e ajrit, përfshirë ndotjen e ajrit në distancë të madhe.

Neni 5

Duhet të bëhen konsultime, sipas kërkesës së bërë, sa më shpejt të jetë e mundur, nga njëra anë ndërmjet palëve kontraktuese të cilat janë efektivisht të prekura ose të ekspozuara ndaj një rreziku potencial nga ndotja ndërkufitare e ajrit në distancë të madhe dhe nga ana tjetër, palëve kontraktuese mbi territorin dhe në juridiksionin e të cilave krijohet ose mund të krijohet një derdhje e madhe e ndotjes ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe si rezultat i aktiviteteve që kryhen, janë kryer ose parashikohen të kryhen.

Neni 6

Administrimi i cilësisë së ajrit

Duke marrë parasysh nenet 2-5, kërkimet në vazhdim, shkëmbimet e informacioneve dhe të aktiviteteve të vrojtimeve dhe rezultatet e tyre, koston dhe efikasitetin e masave korrigjuese të marra lokalisht dhe masave të tjera për të luftuar ndotjen e ajrit, veçanërisht atë me origjinë nga instalimet e reja ose të transformuara, çdo palë kontraktuese angazhohet për të përpunuar politika e strategji më të mira, përfshirë sistemet e administrimit të cilësisë së ajrit dhe në kuadrin e këtyre sistemeve, të masave të kontrollit që janë të pajtueshme me një zhvillim të ekuilibruar, duke iu drejtuar veçanërisht teknologjive më të mira që disponohen dhe ekonomikisht më të zbatueshme si dhe teknikave që shkaktojnë pak ose aspak mbetje.

Neni 7

Kërkimi dhe zhvillimi

Palët kontraktuese, sipas nevojave të tyre, do të ndërmarrin aktivitete bashkëpunimi për kërkim dhe/ose për zhvillim në fushat e mëposhtme:

a) Teknikat ekzistuese dhe të propozuara për pakësimin e shkarkimeve të komponentëve sulfurorë dhe të ndotësve të tjerë të ajrit, përfshirë mundësinë teknike dhe rentabilitetin e këtyre teknikave dhe pasojat e tjera mbi mjedisin;

b) Teknikat instrumentale dhe teknika të tjera që lejojnë të vrojtohen dhe të maten nivelet e shkarkimeve dhe përqendrimit në mjedis të ndotësve të ajrit;

c) Modelet e përmirësuara për të kuptuar më mirë transportin e ndotësve ndërkufitarë të ajrit në distancë

të madhe;

d) Efektet e komponentëve sulfurorë dhe të ndotësve të tjerë kryesorë të ajrit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin, përfshirë bujqësinë, pentarinë, materialet, ekosistemet ujore etj. dhe pamshmërinë me qëllim që të vendoset mbi një bazë shkencore përcaktimi i lidhjeve dozë-efekt për qëllimet e mbrojtjes së mjedisit;

e) Vlerësimin ekonomik, social dhe ekologjik i masave të tjera që lejojnë të arrihen objektivat lidhur me mjedisin, përfshirë pakësimin e ndotjes së ajrit në distancë të madhe;

f) Përmirësimin e programeve të mësimdhënies dhe të formimit mbi ndotjen e mjedisit nga komponimet sulfurore dhe ndotësit e tjerë kryesorë të ajrit.

Neni 8

Shkëmbimi i informacionit

Palët kontraktuese do të shkëmbejnë në kuadrin e organit ekzekutiv të përcaktuar në nenin 10 ose në mënyrë dypalëshe dhe në interesin e tyre të përbashkët informacionet:

a) mbi të dhënat lidhur me shkarkimet, sipas një kohëzgjatje të miratuar dhe të përshtatshme të ndotësve të ajrit duke filluar me SO_2 nisur me rrjetet territoriale me dimensione të përshtatshme ose mbi rrymat e ndotësve të ajrit, duke filluar me SO_2 që kapërcejnë kufijtë e shteteve, në distancë dhe sipas një kohëzgjatjeje të përshtatshme;

b) mbi ndryshimet kryesore të bëra në politikat kombëtare dhe në zhvillimin industrial në përgjithësi dhe efektet e tyre të mundshme, që do të jenë të natyrës për të shkaktuar ndryshime të mëdha të ndotjes ndërkufitare të ajrit në distanca të mëdha;

c) mbi teknikat e reduktimit të ndotjes së ajrit duke vepruar mbi ndotjen ndërkufitare të ajrit në distanca të mëdha;

d) mbi koston e parashikuar të luftës së shkallëzuar të vendeve kundër shkarkimeve të komponentëve sulfurorë dhe të ndotësve të tjerë të ajrit;

e) mbi të dhënat meteorologjike dhe fiziko-kimike, lidhur me dukuritë që ndodhin gjatë transportimit të ndotësve;

f) mbi të dhënat fiziko-kimike e biologjike, lidhur me efektet e ndotjes ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe dhe mbi shtrirjen e dëmeve (1), të cilat sipas të dhënave i takojnë ndotjes ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe;

g) mbi politikat dhe strategjitë kombëtare, nënrajonale dhe rajonale të luftës kundër komponentëve sulfurorë dhe ndotësve të tjerë të ajrit.

Neni 9

Zbatimi dhe zgjerimi i programit të bashkëpunimit për vërtetimin dhe vlerësimin e transmetimit në distanca të mëdha të ndotësve të ajrit në Europë

Palët kontraktuese theksojnë nevojën për zbatimin e “Programit të bashkëpunimit për vërtetimin dhe vlerësimin e transportimit në distancë të madhe të ndotësve të ajrit në Europë” ekzistues (më poshtë i quajtur EMEP) dhe duke vepruar për zgjerimin e këtij programi, kanë dakord për të vënë theksin mbi:

a) Interesimin e tyre për të marrë pjesë dhe për të bërë plotësisht efektiv programin EMEP, i cili në etapën e parë është përqendruar me vërtetimin e vazhdueshëm të dyoksidit të squfurit dhe të substancave që kanë të bëjnë me të;

b) Domosdoshmërinë për të përdorur, sa herë që kjo është e mundur, metoda vërtetimi të krahasueshme ose të normalizuara;

c) Interesimin për të ndërtuar programin e vërtetimit të vazhdueshëm në kuadrin e programeve si kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare. Ndërtimi i stacioneve të vërtetimit të vazhdueshëm dhe grumbullimi i të dhënave që do të nxirren nga juridiksioni i vendeve ku janë vendosur këto stacione;

d) Interesimin për të ndërtuar një kuadër të programit të bashkëpunimit për vërtetimin e vazhdueshëm të mjedisit, i cili të jetë i bazuar mbi programet kombëtare, nënrajonale, rajonale dhe programet e tjera ndërkombëtare aktuale të ardhshme dhe që i merr ato parasysh;

e) Nevojën për të shkëmbyer të dhënat mbi shkarkimet, sipas një kohëzgjatjeje të përshtatshme të ndotësve të ajrit, për të cilët është rënë dakord (duke filluar me dyoksidin e squfurit) me anë të rrjetave territoriale të dimensioneve të përshtatshme ose mbi rrymat e ndotësve të ajrit (duke filluar me dyoksidin e squfurit) që kalojnë kufijtë e shteteve në distanca dhe sipas një kohëzgjatjeje të caktuar. Metoda, përfshirë modelin e përdorur për të përcaktuar rrymat, ashtu si dhe metodat, përfshirë modelin e përdorur për të përcaktuar ekzistencën e transmetimit të ndotësve të ajrit, sipas shkarkimeve nga rrjeta territoriale, do të bëhen të

disponueshme dhe do të kalojnë periodikisht në rishikim për qëllime përmirësimi;

f) Qëllimin e tyre për të ndjekur shkëmbimin dhe azhurnimin periodik të të dhënave ndërkombëtare mbi shkarkimet totale të ndotësve të ajrit për të cilët është rënë dakord, duke filluar me dyoksidin e squfurit;

g) Nevojën për të furnizuar të dhënat meteorologjike dhe fizike, që lidhen me fenomene që ndodhin gjatë transportimit;

h) Nevojën për të marrë përsipër vërtetimin e vazhdueshëm të komponentëve kimikë në mjedise të tjera të tilla, si: ujë, tokë dhe bimësi dhe të zbatohet një program vërtetimi i ngjashëm për të regjistruar efektet mbi shëndetin dhe mjedisin;

i) Interesimin për të zgjeruar rrjetet kombëtare të EMEP-it për t'i kthyer me veprimtari për qëllimet e luftimit dhe të vërtetimit.

Neni 10

Organi ekzekutiv

1. Përfaqësuesit e palëve kontraktuese do të përbëjnë, në kuadrin e këshilltarëve të lartë të qeverive të vendeve të ECE-së për problemet e mjedisit, Organin Ekzekutiv të kësaj Konvente dhe do të mbledhen të paktën një herë në vit në këtë funksion.

2. Organi Ekzekutiv:

a) do të marrë në shqyrtim zbatimin e kësaj Konvente;

b) do të ndërtojë, si t'i duket e përshtatshme, grupet e punës për të studiuar çështjet që lidhen me zbatimin dhe zhvillimin e kësaj Konvente dhe për këtë qëllim për të përgatitur studimet dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe për të parashtruar rekomandimet;

c) do të ushtrojë të gjitha funksionet e tjera që mund të jenë të nevojshme në bazë të dispozitave të kësaj Konvente.

3. Organi Ekzekutiv do të përdorë shërbimet e Organit Drejtues të EMEP-it, me qëllim që ky i fundit të marrë pjesë plotësisht në aktivitetet e kësaj Konvente, veçanërisht për sa i përket grumbullimit të të dhënave dhe bashkëpunimit shkencor.

4. Në ushtrimin e funksioneve të veta, Organi Ekzekutiv do të përdorë gjithashtu, kur ai do ta gjykojë të dobishme, informacionet e marra nga organizatat e tjera ndërkombëtare kompetente.

Neni 11

Sekretariati

Sekretariati Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën do të marrë përsipër, për llogari të Organit Ekzekutiv, funksionet e Sekretariatit si më poshtë:

a) thirrjen dhe përgatitjen e mbledhjeve të Organit Ekzekutiv;

b) transmetimin të palëve kontraktuese të raporteve dhe të informacioneve të tjera të marra, duke zbatuar dispozitat e kësaj Konvente;

c) të gjitha funksionet e tjera që mund t'i besohen nga Organi Ekzekutiv.

Neni 12

Amendimi i Konventës

1. Çdo palë kontraktuese ka të drejtë ligjore të propozojë amendamente në këtë Konventë.

2. Teksti i amendamenteve të propozuara do t'i dorëzohet me shkrim Sekretariatit Ekzekutiv në Komisionin Ekonomik për Europën, i cili do t'ua komunikojë të gjitha palëve kontraktuese. Organi Ekzekutiv do të shqyrtojë amendamentet e propozuara në mbledhjen e tij vjetore më të afërt-ndërkohë këto propozime u komunikohen palëve kontraktuese nga Sekretari Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën të paktën 90 ditë më parë.

3. Një amendament i kësaj Konvente do të miratohet nëpërmjet pëlqimit të përfaqësuesve të palëve kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi për palët kontraktuese që do ta pranojnë ditën e 90-të duke filluar nga data në të cilën 2/3 e palëve kontraktuese do të kenë depozituar instrumentin e pranimi pranë Depozitarit. Më vonë, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha palët e tjera kontraktuese ditën e 90-të, duke filluar nga data në të cilën pala kontraktuese do të këtë depozituar instrumentin e saj të pranimi për amendamentin.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në qoftë se ndodh një mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese të kësaj

Konvente për interpretimin ose zbatimin e Konventës, palët do të kërkojnë një zgjidhje nëpërmjet bisedimeve ose nëpërmjet çdo metode tjetër për rregullimin e mosmarrëveshjeve që të jetë e pranueshme nga ato vetë.

Neni 14 **Nënshkrimi**

1. Kjo Konventë do të hapet për nënshkrim në zyrën e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, nga 13-16 nëntor 1979 me rastin e mbledhjes së nivelit të lartë, në kuadrin e Komisionit Ekonomik për Europën mbi Mbrojtjen e Mjedisit, nga shtetet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, si edhe shtetet që kanë statusin konsultativ pranë Komisionit Ekonomik për Europën, sipas paragrafit 8 të Rezolutës 36 (IV) të 28 marsit 1947 të Këshillit Ekonomik dhe Social dhe nga organizatat e integritit ekonomik rajonal, të ndërtuara nga shtetet sovranë anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, të cilat kanë kompetencë për të biseduar, për të lidhur dhe për të zbatuar marrëveshjet ndërkombëtare në fushat që mbulohen nga kjo Konventë.

2. Për çështjet brenda kompetencave të tyre, këto organizata të integritit ekonomik rajonal do të mundin, në emër të tyre, të ushtrojnë të drejtat dhe të mbartin përgjegjësitë që kjo Konventë u jep shteteve të tyre anëtare. Në raste të tilla, shtetet anëtare të këtyre organizatave nuk do të mund t'i ushtrojnë këto të drejta individualisht.

Neni 15 **Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi**

1. Kjo Konventë do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit.
2. Kjo Konventë do të hapet për pranim, duke filluar që nga data 17.11.1979, për shtetet dhe organizatat e përmendura në paragrafin 1 të nenit 14.
3. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili ushtron funksionin e Depozitarit.

Neni 16 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e 90-të, duke filluar nga data e depozitimit të instrumentit të 24^t të ratifikimit, miratimit, pranimi ose aderimit.

2. Për secilën nga palët kontraktuese që ratifikojnë, miratojnë, pranojnë ose aderojnë në këtë Konventë pas depozitimit të aktit të 24^t të ratifikimit, miratimit, pranimi ose aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e 90-të duke filluar nga data e depozitimit nga palët kontraktuese të instrumentit të tij të ratifikimit, miratimit, pranimi ose aderimit.

Neni 17 **Tërheqja**

Në çdo moment pas pesë vjetësh nga data në të cilën kjo Konventë ka hyrë në fuqi në një palë kontraktuese, ajo palë kontraktuese mund të tërhiqet nga Konventa nëpërmjet njoftimit me shkrim dërguar Depozitarit. Kjo tërheqje do të hyjë në fuqi ditën e 90-të duke filluar nga data e marrjes së njoftimit prej Depozitarit.

Neni 18 **Tekstet autentike**

Origjinali i kësaj Konvente, tekstet e të cilit në anglisht, frëngjisht dhe rusisht janë njësoj autentike, do të depozitohet pranë Sekretariatit të Përgjithshëm pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë, më 13.11.1979.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar pranë:

- njërive postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

- në adresën:

Bulevardi Zhan d'Ark,

pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"

Tel: 042 555 63; 267 468

Përmbajtjen e Fletores Zyrtare mund ta konsultoni edhe në adresën e internetit:

www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI PENAL DHE KODI I PROCEDURËS PENALE (Botim,2005)	700
4.	KODI I PUNËS	500
5.	KODI I FAMILJES	450
6.	KODI CIVIL (Botim, 2005)	1000
7.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
8.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)	355
9.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE (Botim,2005)	500
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim,2005)	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Botim,2005)	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 28.10.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë